

Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme

**Analizë e zgjedhjeve për kryetar
komune në Ferizaj dhe Kaçanik**



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme

**Analizë e zgjedhjeve për kryetar
komune në Ferizaj dhe Kaçanik**

Prishtinë, shkurt 2013

E drejta autoriale © 2013. Demokraci për zhvillim (D4D).
Përgatitur në partneritet me Inicativën për Progres (INPO).



Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar etj., pa lejen me shkrim të D4D-së.

Përgatitur nga:

Leon Malazogu dhe Selatin Kllloqi

Me kontribut nga:

Jetmir Bakija, Drilon Gashi dhe Avni Bytyqi

Përmbajtja

- Falënderimet, 4
- Përmbledhje, 5
Konteksti, 8
- Dy përmirësimet kryesore, 10
Shpërndarja proporcionale e komisionerëve në vendvotime, 10
Pozicioni i ri për vëzhguesit, 13
- Misioni vullnetar i vëzhgimit, 14
Risi në vëzhgim, 14
Monitorimi i ditës së zgjedhjeve, 16
Numërimi paralel i votave dhe komunikimi me media, 16
- Performanca institucionale, 18
Informimi i votuesve, 19
Materiali i ndjeshëm, 20
Përgatitja dhe hapja e vendvotimeve, 21
- Fushata zgjedhore, 22
- Në ditën e zgjedhjeve, 24
Propaganda politike, 24
Drejtorët e shkollave si menaxherë, 25
Mbipopullimi, 26
Votimi i shumëfishtë, 28
Efikasiteti në kabinën e votimit, 29
Votimi familjar dhe ai me asistencë, 30
Votimi me kusht, 32
“Treni bullgar”, 33
- Thirrjet dhe transportimi selektiv, 34*
Forca e Sigurisë, 36
- Trupi zgjedhor, 37
Parregullsitë në listën e votuesve, 37
Sa votues janë?, 38
Dalja në zgjedhje, 43
- Rezultatet e votimit, 46
Përkrahja për partitë politike në Ferizaj, 46
Zhgënjimi i gjerë në Kaçanik, 49
Votat e pavlefshme, 53
- Gratë dhe grupet tjera më pak të përfaqësuara, 55
Bilanci gjinor në KVV, 55
Dalja e grave në zgjedhje, 55
Personat me nevoja të veçanta, 56
- Përfundimet, 58
- Rekomandimet, 60
Menaxhimi i qendrave të votimit, 60
Komisionerët e vendvotimeve, 60
Vëzhgimi, 61
Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), 63
Lista e votuesve, 65
Subjektet politike, 66
Rezultatet dhe drejtësia në zgjedhje, 67

Falënderimet

Demokraci për Zhvillim (D4D) para së gjithash falënderon Iniciativën për Progres (INPO) për partneritet në këtë nismë për vëzhgim të zgjedhjeve. Mirënjohjet gjithashtu u takojnë edhe Qendrës për Politika dhe Avokim (QPA), Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe shumë aktivistëve që ishin vullnetarë në këtë iniciativë të rëndësishme.

Vëzhgimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunës është mundësuar me përkrahje financiare nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Ambasada Franceze në Kosovë dhe nga National Endowment for Democracy (NED). Analiza është bërë e mundur nëpërmjet projektit për reformë të zgjedhjeve „Për përfaqësim të vërtetë në Kosovë“, të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Përbajtja e këtij raporti është në tërësi përgjegjësi e D4D-së.

Përmbledhje

Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Iniciativa për Progres (INPO) shfrytëzuan vëzhgimin e zgjedhjeve për kryetar komune në Kaçanik dhe Ferizaj për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin zgjedhor dhe të ofrojnë rekomandime praktike. Këto dy zgjedhje ndodhën pasi që kryetarët e dy komunave u detyruan të japin dorëheqje për shkak që u gjetën fajtor për vepra penale.

Këto ishin zgjedhjet e para pas zgjedhjeve kontestuese të mbajtura një vit e gjysmë më parë, të cilat u dëmtuan rëndë nga vjedhjet dhe parregullsitë e shumta. Ky punim thekson edhe përmirësimet e rëndësishme që janë vërejtur në procesin zgjedhor. Njëkohësisht, punimi identifikon parregullsi të vazhdueshme dhe sistematike.

Misioni i përbashkët vëzhgues i D4D-së dhe INPO-s shfrytëzoi përvojën e kaluar të vëzhguesve për t'i caktuar ata tek vendet potencialisht më problematike. Vëzhguesit u dërguan në vende të ndryshme nga vendbanimet e tyre, për të kufizuar tendencën për solidaritet lokal dhe për të forcuar paanësinë e tyre. Si rezultat i këtij lloji të caktimit të vëzhguesve, ne përmirësuam raportimin. I rekomandojmë KQZ-së që të miratojë një politikë të ngjashme për caktimin e komisionerëve të vendotimeve.

Disa arritje zgjedhore të iniciuara nga D4D e kanë rritur vetëdijesimin për manipulim në zgjedhje dhe në përgjithësi kanë siguruar një proces zgjedhor më konkurrues. Shoqëria civile i shtyri autoritetet që të caktojnë komisionerët në mënyrë proporcionale që të zvogëlohet mundësia për abuzim. Një sukses tjetër ka qenë vendosja e vëzhguesve prapa komisionarëve, për dallim nga pozicionimi i mëhershëm përballë tyre, gjë që ndikoi dukshëm në përmirësimin e vëzhgimit të tyre. Pjesë e vëzhgimit ishte edhe numërimi paralel i votave, ku rezultatet preliminare u bënë publike më pak se një orë nga mbyllja e procesit të votimit.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, D4D dhe INPO kanë evidentuar disa forma të parregullsive. Propaganda në korridore nga militantë partiak, ndikimi i tepruar i drejtorëve të shkollave, politizimi i administratës zgjedhore mbesin shqetësuese. Ky punim përmend forma të shumta të frikësimit të votuesve, nëpërmjet presionit nga zyrtarët partiak, duke lejuar turma në qendra të votimit apo nga forma të ndryshme të lejimit të blerjes së votës. Për më tepër, krijohet përshtypja që votuesit nuk kishin informacione adekuate se si të votohet dhe gjithashtu ishin të ndikuar nga një masë të madhe të propagandës politike brenda dhe jashtë vendvotimeve. Dëshmia se tetë fletëvotimeve nga raundi i parë, u gjetën në fletëvotimet me kusht të refuzuar, rrisin dyshimin rreth mundësisë së “votimit zinxhior”. Gjithashtu, dalja prej orës 17:00 deri në 19:00 është më e lartë sesa pritet.

Dalja e ulët ka një indikacion pozitiv që do të thotë se ka pasur më pak votime në emër të dikujt tjetër. D4D ka vërejtur një nivel jo të kënaqshëm të daljes në zgjedhje të grave dhe personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja e grave mbetet e ulët edhe pse ka shënuar ngritje nga viti 2007.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i fitoi zgjedhjet në Ferizaj dhe Kaçanik, ku Ferizajn e fitoi pas raundit të dytë. Përderisa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) arriti që të fitojë rreth 42% të votave në raundin e dytë në Ferizaj, ajo përjetoi një rënie drastike (nga rezultatet e saj historike) në Kaçanik, duke siguruar vetëm 6% të votave. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës u rendit e dyta në Kaçanik përderisa Lëvizja Vetëvendosje (VV) e cila për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet komunale u rendit e treta në të dy komunat. Përderisa shpërndarja e votave në mes të vendbanimeve urbane dhe rurale ishte e ngjashme në Ferizaj, rezultatet në Kaçanik tregojnë se PDK-ja doli larg më mirë në vendet rurale krahasuar me rezultatet në qytet.

Një listë e gjatë e rekomandimeve ofrohet në fund të këtij punimi dhe këto përgjithësisht u kushtohen Kuvendit dhe KQZ.

Hyrje

Ky punim ofron një analizë të procesit zgjedhor ashtu siç është vëzhguar gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik. Punimi përdor raportet cilësore dhe sasiore nga vëzhguesit para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve. Analiza përfshin të gjitha fazat e procesit zgjedhor duke filluar nga vëzhgimi i përgatitjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, fushata, dita e zgjedhjeve dhe certifikimi i rezultateve.

Si një kontribuues aktiv në procesin e reformës zgjedhore, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) së bashku me Iniciativën për Progres (INPO) vëzhguan fushatën dhe procesin zgjedhor në të dy komunat. Misioni Vullnetar i Vëzhgimit (MVV) ishte misioni më i përhapur i pavarur për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj dhe Kaçanik, me një vëzhgues për çdo vendvotim.

Punimi vjen rreth gjysmë viti pas zgjedhjeve, por qëllimi nuk ka qenë që të raportohen shkeljet e veçanta. Qëllimi i punimit është të analizohet procesi në thellësi dhe të nxirren mësimet për zgjedhjet e ardhshme. Punimi raporton mbi integritetin e procesit dhe sugjeron përmirësime që duhet të miratohen për zbatim nga autoritetet dhe për përfshirje në legjislacionin i cili është duke u reformuar.

Duhet të theksohet se organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në vetëm një komunë nuk duhet të merret si barometër i procesit dhe paraqet skenarin e rastit më të mirë. Krahasuar me zgjedhjet e përgjithshme, zgjedhjet për kryetar komune janë shumë më e lehtë si për të organizuar ashtu edhe për të vëzhguar.

Fakti që kishim vetëm një palë zgjedhje të thjeshta në një komunë të vetme na mundësoi që të analizojmë procesin në detaje. Fakti që kishte fenomene shqetësuese edhe në këto zgjedhje të lehta për tu menaxhuar, konfirmojnë

dyshimin se me rregullimin aktual, zgjedhjet në nivel vendi do të ballafaqoheshin me probleme madhore.

Përveç vëzhgimit të zgjedhjeve, D4D vëzhgon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe gjatë punës së tyre, ka vëzhguar edhe Komisionin Parlamentar për Reformë Zgjedhore dhe Grupin Punues për Reformë Zgjedhore. D4D gjithashtu ka themeluar një forum të shoqërisë civile (Forumi “Reforma”) i cili ka mundur një debat të gjerë dhe ndërtim të konsensusit për tema të ndryshme në lidhje me legjislacionin zgjedhor.

Vëzhgimi i institucioneve të përmendura më lartë si dhe përgatitjet për dy komunat në fjalë i mundësuan shoqërisë civile që të përfshijë dy ndryshime kryesore para zgjedhjeve që kanë kontribuar në parandalim të keqpërdorimeve. Dy ndryshimet e përfshira në moment të fundit nën presionin e shoqërisë civile ndikuan në riparim të pjesshëm të besimit në proces. Pjesa e fundit e këtij punimi rekomandon ndryshime shtesë për autoritetet.

Konteksti

Në mars të vitit 2012, Gjykata Supreme nxori një vendim për dënim me dy vite burgim për kryetarin e komunës së Ferizajt për shkak të shkaktimit të një aksidenti në trafik me pasojë vdekjen e një personi. Në maj të vitit 2012, e njëjta gjykatë nxori vendim për kryetarin e komunës së Kaçanikut për kërcënim dhe posedim të paligjshëm të armëve. Të dy kryetarët dhanë dorëheqje nga postet e tyre dhe u organizuan zgjedhje të jashtëzakonshme për t'i zëvendësuar ata.

Dy palë zgjedhjet e jashtëzakonshme ndodhën një vit e gjysmë pas zgjedhjeve kombëtare të vitit 2010, të njohura për “manipulime të nivelit industrial”¹. Këto zgjedhje të jashtëzakonshme paraqitën një mundësi të mirë për administruesit e zgjedhjeve që të rikthejnë një pjesë të

besimit të humbur. Përgatitja joadekuade për zgjedhjet në Ferizaj ngriti shqetësim për përsëritje të manipulimeve të mëparshme.

Këto zgjedhje erdhën në një moment të favorshëm për procesin akoma të hapur të reformës zgjedhore. Komisioni parlamentar për reformë zgjedhore ka hasur në bllokadë për shkak të pamundësisë të vendos për sistemin zgjedhor. Njëkohësisht, Komisioni duhet rifreskuar me detyrë të re, të caktojë si prioritet zvogëlimin e hapësirës për manipulim në procesin zgjedhor.

Dy përmirësimet kryesore

Krahas vëzhgimit të votimeve, u arritën dy përmirësime të praktikës zgjedhore. Ashtu siç sofistikoheh partitë dhe politikanët individual për të manipuluar zgjedhjet, shoqëria civile dhe administruesit e zgjedhjeve duhet të mbajnë hapin dhe mësojnë si të identifikojnë dhe raportojnë parregullsitë.

Shpërndarja proporcionale e komisionerëve në vendvotime

Një aspekt i dyshimtë i procesit zgjedhor ishte roli i komisionerëve në vendvotime. Është e çuditshme se as ligji dhe as aktet nënligjore nuk rregullojnë shpërndarjen e detyrave që komisionarët kryejnë gjatë ditës së zgjedhjeve. Rregullimi i punës së komisionerëve është pjesë tejet e rëndësishme e procesit zgjedhor dhe neglizhenca për të rregulluar këtë nuk mund të jetë e rastësishme.

Shoqëria civile kishte brengë se një nga funksionet e komisionarëve ishte thelbësore dhe instrumentale në mundësimin e votimit të shumëfishtë. Kontrolluesi i letërnjoftimit mund të mundësojë votimin në emër të dikujt tjetër dhe nënshkrimin pranë emrit të tjetërkujt.

Është shumë e dyshimtë se as anëtarët e KQZ-së nuk kishin qasje tek informacioni se si ishin ndarë komisionarët. Kërkesat tona për të kuptuar mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjen e komisionarëve karshi rolit të tyre në vendvotim nuk u morën parasysh.

D4D përfundimisht siguroi listën e shpërndarjes së komisionarëve e cila paraqiste emrat në radhitje por ndarja në poste ishte sërish e paqartë. Pas një analizë të kujdesshme erdhëm në përfundim shqetësues – tri të katrat e kontrolluesve të letërnjoftimeve u ishin shpërndarë PDK-së dhe një e katërta LDK-së. Përderisa LDK-ja duket të jetë pjesë e skemës, heshtja e partive tjera politike tregon që ato

nuk ishin në dijeni për këtë. Ky është një shembull ilustrativ për mungesë shqetësuese të opozitës brenda KQZ-së.

D4D e ngriti këtë shqetësim në një program televiziv mjaft të shikuar². Edhe pse programi përfundoi pak para mesnate, KQZ-ja arriti të organizojë një mbledhje urgjente të nesërmen në ora nëntë të mëngjesit. KQZ nuk e informoi D4D-së (si vëzhgues të akredituar) për mbledhjen. Një zyrtar i lartë i këtij institucioni madje nuk hezitoi që ta pyesë vëzhguesin e D4D-së se nga e mori vesh që do të mbahej takimi.

Si u ndanë komisionerët në mes partive?


	KVV1	KVV2	KVV3	KVV4
1 Kryesuesi i KVV-së	PDK	LDK	VV	AKR
2 Zyrtari i identifikimit	LDK	PDK	PDK	PDK
3 Dhënësi i fletëvotimeve	VV	VV	LDK	LDK
4 Zyrtari i kutive të votimit	AKR	AKR	AKR	VV
5 Kontrolluesi i rreshtit	AAK	AAK	AAK	AAK
6 Asistenti	PD	PD	PD	PD
7 Asistenti	LB	LB	IC	IC

... dhe vazhdon kështu për të gjitha KVV-të

Disa nga anëtarët e KQZ-së përdorën gjuhë fyese ndaj përfaqësuesit të D4D-së. Përkundër kundërshtive, në po të njëjtin takim KQZ-ja parimisht vendosi pikërisht veprimin e propozuar, duke ndarë postin e kontrolluesve të letërnjoftimit tek të gjitha subjektet në mënyrë proporcionale.

Ndarja proporcionale doli të jetë aq e dobishme sa që jo vetëm që u përdor në raundin e parë në Ferizaj, por po ashtu u përdor në raundin e dytë dhe në zgjedhjet pasuese në Kaçanik. Mund të duket si detaj, por është shumë e këshillueshme që kjo praktikë mos të mbetet në diskrecion

të KQZ-së e cila zgjidhet me kriter politik, por të përfshihet në ligjin për zgjedhjet si praktikë e përhershme.



Pozicioni i ri për vëzhguesit

Kishim po ashtu brengën nëse vëzhguesit mund të shohin nëse votuesi voton me letërnjoftimin e vet dhe nëse nënshkruhet pranë emrit të tij. Kjo ka shpie në kërkesën që vëzhguesit të lejohen që të ulen prapa komisionarëve që kontrollojnë letërnjoftimet. Ne kemi insistuar në mundësinë që të vëzhgojmë nga së afërmi procesin e votimit, siç edhe parashihet me ligj.

Pozicioni i mëhershëm i vëzhguesve ka mundësuar afërsi fizike, por vëzhguesit nuk kanë pasur mundësi të verifikojnë identifikimin dhe nënshkrimin. Pozicioni i ri u lejon vëzhguesve që të krahasojnë emrin e votuesit në listë me atë që shkruan në letërnjoftim sikurse edhe fotografinë në letërnjoftim të votuesit. Ky propozim po ashtu u miratua nga KQZ-ja.

Në raundin e parë në Ferizaj, në 5% të vendvotimeve, vëzhguesit nuk ishin lejuar që të uleshin prapa komisionerit në mënyrë që të kontrollojnë identifikimin e dokumenteve. Ky problem nuk ishte përsëritur në raundin e dytë ose në Kaçanik, gjë që dëshmon që komisionerët u mësuan me këtë lloj të vëzhgimit, siç edhe kërkohet me procedurat e reja.

Misioni vullnetar i vëzhgimit

Vëzhguesit kanë monitoruar po ashtu edhe punën e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) si dhe kanë ndjekur përgatitjet dhe fushatën. D4D dhe INPO kanë rekrutuar 124 vëzhgues për secilin raund të zgjedhjeve në Ferizaj dhe 42 vëzhgues në Kaçanik (një total prej 290 vëzhguesve). Tri deri në katër ekipe mobile nga dy vëzhgues kanë vizituar qendra të ndryshme të votimit gjatë ditës së zgjedhjeve. Itinerari i tyre i rregullt nganjëherë ka devijuar për të vizituar zonat ku raportoheshin parregullsitë.

Fushata dhe heshtja parazgjedhore janë vëzhguar nga vëzhgues afatgjatë të kualifikuar. Vëzhguesit afatgjatë (nga stafi i INPO-s), ishin trajnuar se si të raportojnë për aktivitetet kryesore të organizuara nga subjektet politike dhe u pajisën me formularët përkatës. Gjatë pesë ditëve të fushatës zgjedhore, vëzhguesit afatgjatë kanë ndjekur aktivitetet kryesore të organizuara nga subjektet politike dhe kanë përgatitur raporte me shkrim, duke përshkruar llojin e aktivitetit, shënuar detaje për incidentet dhe shkeljen e Kodit të Mirësjelljes. Raportet për fushatën zgjedhore dhe heshtjen zgjedhore janë publikuar në faqet elektronike të D4D-së dhe INPO-s dhe shpesh janë cituar nga mediat³.

Deri në 20 persona kanë qenë aktiv në qendrën e thirrjeve, përgjegjës për mbledhje të të dhënave, futje të të dhënave, përgatitje të komunikatave për shtyp, adresim të çështjeve logjistike dhe mbajtje të kontakteve me media.

Risi në vëzhgim

D4D mban një bazë të të dhënave të rezultateve nga të gjitha zgjedhjet e kaluara, për vendvotime. Bazuar në tre indikatorët nga vitet e kaluara: (a) dalja e lartë e dyshimtë, (b) raportet për parregullsi, dhe (c) përvoja dhe zotësia e vëzhguesve, Misioni Vëzhgues me kujdes i ka vendosur vëzhguesit me më shumë përvojë në ato vendvotime me

probabilitet më të lartë për tendenca të manipulimit.

Misioni Vullnetar Vëzhgues (MVV) tani mirëmban një listë të vëzhguesve që kanë vëzhguar tri palë zgjedhje dhe që janë vlerësuar individualisht për performancën e tyre. Kjo mundëson një organizim të misioneve të ardhme vëzhguese duke zbarkuar vëzhguesit më kompetent në zonat ku priten më shumë keqpërdorime.

Nga përvoja e mëhershme me misionet vëzhguese, Misioni Vëzhgues i druhej solidaritetit lokal si një nga pengesat kryesore për punë të suksesshme. Nëse komisionarët dhe vëzhguesit vijnë nga e njëjta zonë ku shërbejnë në ditën e zgjedhjeve, kjo shpesh i bën të anojnë. Madje edhe nëse ata nuk kanë tendencë për manipulim, presioni nga kolegët dhe bashkë-qytetarët shpesh është i madh dhe i shtyn komisionerët dhe vëzhguesit që të mbyllin njërin sy ndaj vjedhjeve që bëhen nga bashkëvendësit apo nga bashkë-partiakët e tyre.

Përkundër komplikimeve logjistike shtesë, misioni vendosi që të caktojë vëzhguesit larg vendbanimeve të tyre. Mësimi i nxjerrë është që ia ka vlejtur, dhe se të dhënat e mbledhura gjatë ditës së zgjedhjeve dhe raportimet në formularë kanë qenë më të pasura dhe më të sakta sesa në të kaluarën. D4D ka lobuar për një politikë të ngjajshme për zbarkim të komisionerëve të adaptohet nga KQZ-ja ose të përfshihet në ligj.

Menjëherë pas raundit të parë në Ferizaj, misioni erdhi në përfundim se vjedhja brenda vendvotimeve është zvogëluar ndjeshëm. Përkundër asaj se kishte vetëm një muaj ndërmjet zgjedhjeve në Kaçanik dhe në Ferizaj, misioni vëzhgues tentoi që të tani të përqendrohet dhe të vëzhgojë zonat përreth vendvotimeve, përfshirë edhe korridoret në qendra të votimeve, zonat afër qendrave të votimit dhe në rrugë. Në këtë mënyrë, vëzhgimi u përpoq të vlerësojë më mirë shkallën e manipulimeve dhe kërcënimet e votuesve jashtë vendvotimit.

Të gjitha informatat e mbledhura nga vëzhguesit statik dhe ata mobil, nga faza përgatitore e deri sa është mbyllur votimi janë futur në një bazë të të dhënave. Informatat janë analizuar me kujdes dhe rezultatet janë paraqitur në këtë punim.

Monitorimi i ditës së zgjedhjeve

Në ditën e zgjedhjeve procesi ka filluar para agimit dhe vëzhguesit kanë vëzhguar dorëzimin e materialeve të ndjeshme (llambat ultravjollcë, ngjyrën e padukshme, fletëvotimet) tek kryesuesit e këshillave të vendvotimeve. Një raport i detajuar për dorëzim pranimin e materialit të ndjeshëm është përgatitur nga vëzhguesit⁴. Nuk janë vërejtur probleme të ndjeshme gjatë këtij procesi.

Rreth 70% e vëzhguesve tanë kanë arritur në vendvotimin e caktuar para orës 06:15 për të vëzhguar përgatitjet, dhe të gjithë përveç njërit (289), kanë arritur para fillimit të procesit të votimit në ora 07:00.

Të gjithë vendvotimet (124 në Ferizaj dhe 42 në Kaçanik) janë mbuluar së paku me nga një vëzhgues. Vëzhguesit kanë qëndruar në vendvotim deri në përfundimin e numërimit dhe i kanë dorëzuar formularët tek mbikëqyrësi i para-caktuar.

Secili vëzhgues ka qenë i pajisur me një formular për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, me rreth 70 pyetje për procesin duke filluar nga përgatitjet deri në përfundim të numërimit në vendvotim. Këto pyetje janë proceduar në mënyrë kuantitative dhe janë përdorur në këtë raport.

Numërimi paralel i votave dhe komunikimi me media

Në të tri ditët zgjedhore (raundi i parë dhe i dytë në Ferizaj, si dhe zgjedhjet në Kaçanik), D4D/INPO kanë lëshuar komunikata për media në fund të ditës, si dhe u janë përgjigjur një numri të madh të ftesave nga mediat. Komunikata e parë për media (lëshuar në ora 08:30) ka raportuar për hapjen e vendvotimeve dhe nëse ato ishin të

pajisura me të gjitha materialet e nevojshme për proces zgjedhor.

Një qendër e thirrjeve ishte krijuar në selinë e misionit të përkohshëm (zyrat e INPO-s në Ferizaj dhe një zyrë me qera në Kaçanik). Qendra e thirrjeve mbledhi informata për shkeljet dhe incidentet siç ndodhnin dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me vëzhguesit dhe koordinatorët e qendrave të votimit për daljen në votime në periudha të ndryshme kohore gjatë gjithë ditës.

Ekipit të ngarkuar për mbledhjen e raporteve të manipulimeve dhe incidenteve gjatë ditës iu bashkëngjiten vullnetarë shtesë tri herë gjatë ditës, për të mbledhur informata mbi daljen në mesditë, në ora 17:00 dhe për të mbledhur rezultatet preliminare menjëherë pas numërimit të tyre. KQZ-ja ka mbledhur daljen në votime në ora 11:00 dhe në ora 15:00.

Dalja në votime e matur në mesditë ishte publikuar së bashku me një përmbledhje të procesit në ora 13:00 në komunikatën e dytë për shtyp⁵. Dalja në votime e matur në ora 17:00 ishte publikuar me një përmbledhje të shkeljeve në ora 18:00 në komunikatën e tretë⁶.

Mbyllja, dalja e përgjithshme dhe rezultatet paraprake jo-zyrtare janë bërë publike në një konferencë për shtyp, shumë shpejt pas mbylljes së vendvotimeve (në 20:55 në Ferizaj në raundin e parë dhe në 20:25 në raundin e dytë në Ferizaj dhe Kaçanik). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) raportoi shifra pothuajse të njëjta rreth një orë e gjysmë pas me ndihmën e një kontraktori komercial. Rezultatet janë publikuar menjëherë në faqet tona të internetit dhe kanë qenë të qasshme për publikun e gjerë dhe mediat.

Publikimi i hershëm i rezultateve është përherë i dobishëm për të ulur tensionet, i jep procesit besueshmëri shtesë dhe redukton mundësinë e kundërshtimit të rezultateve.

Performanca institucionale

Përgatitjet teknike të KQZ-së për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj kanë qenë të vështira dhe janë përshkuar me diskutime të nxehta. Ky punim trajton shumicën nga çështjet në pjesët tematike, por çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë direkte të KQZ-së trajtohen këtu.

Elektorati në Ferizaj dhe në Kaçanik është rritur në krahasim me zgjedhjet e fundit dhe si rrjedhojë është rritur edhe numri i vendvotimeve (për 2 në Ferizaj) si dhe numri i votuesve për vendvotim (nga 750 në 950). Për shkak të procedurës së thjeshtë të votimit (një shenjë për kryetarin), rritja e numrit nuk është problematike, por është shqetësuese nëse e njëjta politikë përdoret edhe për zgjedhje tjera në të ardhmen.

KQZ-ja ka miratuar numrin e fletëvotimeve që duhet shtypur, 5% më shumë se sa numri i votuesve me të drejtë vote në listë të votuesve. Sidoqoftë, numri i fletëvotimeve të shtypura ka qenë afër 10% mbi këtë. Pas ankesës së një anëtarit të opozitës në KQZ, numri u reduktua në 5%⁷.

Ka pasur raste të shumta të intervenimit të KQZ-së dhe KKZ-së gjatë ditës së zgjedhjeve. Një shembull i jashtëzakonshëm ka qenë intervenimi i një zyrtari të SKQZ-së i cili kishte shkuar për të zgjidhur një mosmarrëveshje të nxehtë në Ferizaj. Një votues ka insistuar që të votojë edhe pse një nënshkrim ishte vendosur poshtë emrit të tij, duke treguar që ai kishte votuar. Në mënyrë pragmatike, zyrtari sugjeroi që atij personi t'i lejohet që të votojë duke shkruar emrin e tij me dorë sërish dhe duke u nënshkruar pranë⁸.

Në Doganaj, vëzhguesit e shoqërisë civile raportuan për një rast kur një vëzhgues i PDK-së tentoi të votojë me kopje të letërnjoftimit të tij (e ndaluar me ligj) që eskaloi në përleshje kur kryetari i KVV-së nuk e lejoi atë që të votojë⁹. Në një

vendvotim në Gllloboçicë, u raportua se një vëzhgues i PDK-së ka luajtur rolin e komisionarit duke spërkatur gishtërinjtë tregues të votuesve, me leje të KVV-së. Lëvizja Vetëvendosje ka raportuar që vëzhguesit e PDK-së në fshatin Kovaçec në mënyrë të vazhdueshme i kanë huazuar bexhat tek individë tjerë që nuk kanë qenë të akredituar si vëzhgues – kështu që ata mund të rrinin në qendra të votimit dhe të ushtronin presion tek votuesit. Edhe në Ferizaj, vëzhguesit kanë vërejtur që në disa vendvotime, vëzhguesit e PDK-së i kanë ndryshuar shumë shpesh vendvotimet e tyre duke shkaktuar tollovi brenda vendvotimeve.

Komisionerët nuk kanë qenë të interesuar për të ndaluar votimin familjar, duke e toleruar atë dhe trajtuar si një normë të pranuar gjerësisht. Dukej qartë se trajnimet nuk kanë qenë adekuate dhe një numër i komisionerëve nuk kishin njohuri për rregullat zgjedhore.

Vëzhguesit kanë raportuar raste kur komisionerët nuk kanë qenë të sigurt si të vendosin fletëvotimet e numëruara në thasët përkatës¹⁰. Në 11% të vendvotimeve, vëzhguesit kanë raportuar se ka pasur më pak se pesë komisionarë të pranishëm në vendvotim. Shpesh, vetëm dy apo tre komisionarë kanë qenë të pranishëm gjatë procesit të votimit.


Informimi i votuesve

Fushata e informimit të votuesve për procesin zgjedhor e financiar dhe e organizuar nga KQZ ka qenë simbolike. KQZ-ja kishte vendosur që fushata e informimit të përmbajë (a) një spot televiziv për dalje në votime dhe (b) të vendos dy tenda në Ferizaj për të udhëzuar votuesit se si duhet votuar. Këto pika statike në Ferizaj kanë qenë po ashtu aktive edhe një ditë para ditës së zgjedhjeve. KQZ-ja po ashtu ka dërguar letra edhe votuesve që kanë mbushur moshën 18 vjeçare të cilët kanë fituar të drejtën e votës. Ata po ashtu kanë raportuar se ju kanë dërguar letra edhe votuesve të cilëve u

është ndërruar qendra e votimit për shkak të ndërrimit të adresave të tyre të vendbanimit. D4D/INPO kanë përdorë mediat kombëtare dhe rajonale për t'ju bërë thirrje të gjithë votuesve që të dalin dhe të votojnë në zgjedhjet e Ferizajt dhe Kaçanikut.

Brenda vendvotimeve, informatat se si duhet të votohet kanë munguar në çdo të pestin vendvotim në raundin e parë që është përkeqësuar tutje në raundin e dytë. Në vitin 2007, informatat si votohet mungonin vetëm në 4% (në nivel kombëtar)¹¹.

Materialet dhe pajisjet në vendvotim



Materiali i ndjeshëm

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) është përgjegjës për organizimin e operacioneve gjatë ditës së zgjedhjeve në secilën komunë. Një nga detyrat kryesore të KKZ-së është që

të dorëzohet materialin e ndjeshëm tek kryesuesit e KVV-ve herët në mëngjes në ditën e zgjedhjeve. Në Ferizaj, procesi i dorëzimit ka shkuar mirë përveç në tri raste kur persona tjerë kanë pranuar materialin e ndjeshëm në vend të kryesuesve.

Më alarmuese për të mbrojtur një proces nga vjedhjet ka qenë që në 14-17% të vendvotimeve (në raundin e parë dhe të dytë në Ferizaj) ngjyra e padukshme nuk është treguar me paketim të prodhuesit (7,5%) në Kaçanik. Aktualisht, ngjyra paketohet nga KQZ-ja së bashku me materialin tjetër, përderisa D4D insiston që ngjyra të jetë në paketimin e prodhuesit origjinal.

Në 1,6-3,3% të vendvotimeve (në raundin e dytë përkatësisht të parin në Ferizaj), llambat ultravjollcë nuk ishin testuar nëse funksionojnë (2,4% në Kaçanik). Llambat ultravjollcë me bateri të dala afati kanë qenë një problem i madh në vitin 2010 dhe neglizhenca e tyre tregon për problemet sistematike me llogaridhënien dhe zinxhirin e përgjegjesisë.

Përgatitja dhe hapja e vendvotimeve

Përgatitja e vendvotimeve (paraparë për orën 06:00) ka filluar me 15-30 minuta vonesë në 44% të vendvotimeve. Procedurat e numërimit në përgjithësi u respektuan, siç u plotësuan edhe kriteret tjera teknike si tregimi i kutisë së zbrazët, vendosja e kabinave të votimit në mënyrë të rregullt, apo shënimi i numrave serial. Të gjitha vendvotimet janë mbyllur ndërmjet orës 19:00 dhe 19:15. Në këtë kohë, në ato vendvotime ku ka pasur votues në radhë (9% të vendvotimeve) ata janë lejuar të votojnë.

Fushata zgjedhore

Fushata zgjedhore për raundet e para (Ferizaj dhe Kaçanik) ka zgjatur pesë ditë dhe për raundin e dytë në Ferizaj vetëm tri ditë. Në përgjithësi, fushata ka qenë e qetë dhe pa incidente serioze. Sidoqoftë, vëzhguesit afatgjatë kanë raportuar një listë të gjatë të shkeljeve të bëra nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore, veçanërisht gjatë raundit të parë në Ferizaj.

Aktivitetet e fushatës zakonisht zhvillohen në shkolla, shtëpi të kulturës, restorante, bare apo shtëpi private. Të gjitha subjektet politike (përfshirë edhe kandidatët e pavarur) si dhe KQZ-ja kanë shkëlur ligjin për zgjedhje duke vendosur materiale zgjedhore në drunj dhe duke uzurpuar hapësirën publike. Në rastet e transmetimit të porosive të tyre, militantët partiak shpesh e kanë injoruar Kodin e Mirësjelljes dhe kanë keqpërdorur pronën dhe pasurinën publike.

Shumë zyrtarë të qeverisë të nivelit qendror dhe komunal i kanë përdorur veturat zyrtare për qëllime të fushatës. Një numër i theksuar i fëmijëve kanë qenë të pranishëm në tubimet e PDK-së (p.sh. në fshatin Balaj). PDK-ja po ashtu ka përdorur përparësinë e të qenit në pozitë dhe ka shkëlur kornizën ligjore duke takuar punëtorët e shëndetësisë për arsye politike dhe lobuese.

Drejtorë të institucioneve të ndryshme shëndetësore janë parë në takime të PDK-së gjatë orarit të punës. Grupe të organizuara të mësuesve kanë marrë pjesë në takime të PDK-së, sidomos në fshatra. Në ditën e fundit të fushatës, Nehat Mustafa (Zëvendës Ministër i Arsimit) ka pasur një takim me maturantë për të diskutuar me ta provimin e maturës, por kjo në rend të parë u përdor për qëllime të fushatës.

Pjesëmarrja e qytetarëve në fushatë ka qenë relativisht e ulët

në raundin e dytë, dhe në to merrnin pjesë kryesisht anëtarët e partive politike. Bazuar në vëzhguesve, mesatarisht rreth 100 persona kanë marrë pjesë në secilin tubim të fushatës zgjedhore në raundin e dytë në Ferizaj. Pjesëmarrja e grave ka qenë shumë e ulët dhe fëmijët kanë qenë pjesë e fushatës.

LDK-ja ka qenë e para që ka shkelur fillimin e fushatës zgjedhore duke vendosur posterë të kandidatëve të tyre në hapësira publike dhjetë orë para fillimit të fushatës. LDK-ja po ashtu ka penguar lirinë e lëvizjes duke vendosur pllakata zgjedhore në pjesët e rrugës për këmbësorë. PD-ja ka vendosur material zgjedhor të kandidatit të tyre përgjatë rrethojës së Xhamisë së Madhe.

Në ditën e zgjedhjeve

Përderisa zgjedhjet në përgjithësi janë cilësuar që plotësojnë standardet, mjaft parregullsi u shfaqën në Ferizaj dhe në Kaçanik.

Propaganda politike

Edhe pse e ndaluar me ligj, propaganda politike ishte e pranishme në shumë vendvotime. Vëzhguesit kanë vërejtur dy lloje të propagandës politike, materiale të fushatës zgjedhore brenda vendvotimeve dhe posterë politik në afërsi të qendrave të votimit.

Niveli i propagandës politike ka dalluar dukshëm, nga propaganda intensive në disa vendvotime dhe pak në disa tjera. Vëzhguesit kanë regjistruar 18 vendvotime ku ka pasur raste kur votuesit janë lejuar që të votojnë (apo komisionerët të flasin) edhe pse kanë bartur material të tillë. Kjo zakonisht ka ndodhur kur votuesit me bluzë, bexh apo flamur të një partie të caktuar politike janë lejuar që të futen në vendvotim dhe të votojnë.


Propaganda brenda vendvotimeve ka qenë e pranishme në 16,5% të vendvotimeve përderisa ndikimi ishte përqendruar në propagandën në korridore (43%). Kjo është shumë më e lartë sesa mesatarja në nivel Kosove, (15% dhe 11% përkatësisht, e vërejtur gjatë vitit 2007)¹². ‘Lobimi’ brenda vendvotimeve ka qenë më shumë i përhapur në Kaçanik (43%) ndërsa ndikimi në korridore është shfaqur në më shumë se gjysmën e qendrave të votimit (54%).

Një shembull i propagandës politike ka qenë zilja e një telefoni të një vëzhguesi të PDK-së me një melodi të një fjalimi të kryetarit të PDK-së që bënte thirrje për të votuar PDK-në. Një vëzhgues i Vetëvendosjes i pranishëm aty insistoi që të shkruajë ankesë por nuk u lejua nga kryesuesi i KVV-së.

Materiali propagandues nuk ishte larguar nga hapësira e

caktuar prej 100 metrave në 19% të qendrave të votimit në Kaçanik (16% dhe 6% në dy raunde në Ferizaj, respektivisht).

Propaganda Politike



Drejtorët e shkollave si menaxherë

Roli teknik i menaxhimit të qendrave të votimit i caktuar për drejtorët e shkollave ka sjellë mjaft shqetësime sa i përket procesit zgjedhor. Menaxherët/drejtorët e shkollave shpeshherë kanë tejkalluar kompetencat e tyre logjistike dhe janë përfshirë në procesin zgjedhor.

Rasti më i dyshimtë u shfaq kur menaxheri i qendrës së votimit (drejtori i shkollës) ushtronte presion ndaj komisionarëve për të lejuar një person për të votuar pavarësisht faktit se ai ishte refuzuar për shkak se pranë emrit të tij kishte nënshkrim.

Është më se e njohur që drejtorët e shkollave emërohen si shpërblim për përkrahësit më aktiv të partive politike. Lejimi i një drejtori të shkollës që të emërojë personelin e tavolinës

ndihmëse ngrit shqetësime se votuesit e partive opozitare mund të refuzohen më shpesh. Gjatë raundit të parë të zgjedhjeve në Ferizaj, vëzhguesit tanë kanë parë që një kopje e listës së votuesve mbahej në zyrat e drejtorëve të shkollave. Vetëm disa anëtarë të PDK-së kanë pasur qasje në të.

Në shumicën e rasteve, personeli ndihmës përbëhej nga arsimtarët dhe punëtorë tjerë të shkollave, megjithatë ka pasur edhe raste më të rënda. Në Kaçanik, ka pasur një rast kur drejtori i Urbanizmit të komunës (një anëtar i PDK-së), ka shërbyer si asistent në tavolinën ndihmëse.

Personeli logjistik po ashtu ka rol në menaxhimin e turmave dhe sigurimin e një procesi të rregullt në korridore. Lejimi i turmave mundëson mbylljen e syrit apo asistimin e militantëve partiak për të kërcënuar votuesit.

Mbipopullimi


Nuk është befasi të shihen korridore të mbingarkuara (pavarësisht procesit të thjeshtë të votimit me vetëm një shenjë për një kandidat). Shumica e korridoreve ishin përplot me militantë partiak që sorollateshin gjatë gjithë ditës me detyrë të caktuar. Drejtorët e shkollave qartazi nuk i kanë kryer detyrat e tyre për të siguruar korridore të lira në qendrat e votimit.

Turmat në korridoret e qendrave të votimeve kanë qenë shumë të shpeshta gjatë zgjedhjeve. Vëzhguesit kanë shënuar “shpesh të ngarkuara” në 5-10% të qendrave të votimit (përfshirë të dy raundet në Ferizaj dhe zgjedhjet në Kaçanik). Vëzhguesit kanë shënuar “nganjëherë të ngarkuara” në 51-76% të vendvotimeve, për të tri zgjedhjet. Korridoret e mbingarkuar me persona të paautorizuar shfaqën paaftësinë apo mos-vullnetin e drejtorëve të shkollave për të kryer një nga detyrat e vetme që kanë.


Vendvotimet kanë qenë po ashtu të ngarkuara, edhe pse më pak se korridoret. Vetëm 1% e vendvotimeve në Ferizaj (e

njëjtë në të dy raundet) kanë qenë “shpesh të ngarkuara”, krahasuar me afër 8% në Kaçanik. “Nganjëherë të ngarkuara” ishin 44,5% (Ferizaj, raundi i parë) deri në 70% (Kaçanik).

Korridoret e mbingarkuara në qendra të votimit



Overcrowded Polling Station



Votimi i shumëfishtë

Ngjyra e padukshme praktikisht është kontrolluar gjithmonë mirëpo ka pasur raste të shumta kur persona me ngjyrë të padukshme në gishtat e tyre kanë tentuar të votojnë (që nënkupton se ata do të votonin për herë të dytë). Disa ia dilnin mbanë me bekimin e komisionerëve. Ishte edhe një rast kur një votues solli vendimin e KQZ-së për ta lejuar të votojë pavarësisht se kishte ngjyrë në gishtin e tij¹³.

Një votues tjetër që kishte ngjyrë në gisht po ashtu ishte lejuar të votojë pas ardhjes së policisë dhe dy anëtarëve të Sekretariatit të KQZ-së¹⁴. Argumenti i dhënë ishte se ngjyra kishte ardhur nga prekja e një personi tjetër i cili kishte votuar - një shkelje e qartë - që u lejua me bekimin e autoriteteve zgjedhore.

Votues që kanë hasur në nënshkrim tek emri i tyre në LV



Ka pasur raste kur votuesit me letërnjoftime të skaduar nuk janë lejuar të votojnë. Gjatë pasdites, udhëheqësi i Komisionit Komunal Zgjedhor urdhëroi kryesuesin që t'i lejojë këta individë që të votojnë, që po ashtu është një shkelje e rregullave, siç është votimi me kopje të letërnjoftimeve që gjithashtu është lejuar në disa raste.


Këto raste, disa herë kanë shpie drejt tensioneve gjatë procesit të votimit, si atëherë kur një person (pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës) nuk është lejuar të votojë për shkak se nën emrin e tij në listën e votuesve tashmë kishte nënshkrim. Ky person më vonë është kthyer në vendvotim

bashkë me menaxherin e Qendrës së Votimit (drejtorin e shkollës) i cili iu ka bërë presion komisionerëve që ta lejojnë të votojë, ngjashëm me rastet kur anëtarët e KKZ-së kanë vepruar më vonë gjatë ditës nëpër vendvotime.

Efikasiteti në kabinën e votimit

Në të kaluarën ka pasur raporte të pagesës së votuesve për të votuar e të cilët e kanë dëshmuar këtë përmes fotografimit të fletëvotimit të tyre. Përderisa ishin raportuar raste individuale, misioni i vëzhgimit ka vendosur që të masë kohën që u është dashur votuesve për të votuar brenda kabinës së votimit si një indikator i mundshëm.

Koha mesatare e votimit brenda kabinës së votimit



Formularët për vëzhguesit ishin dizajnuar në formë adekuate ndërsa vëzhguesit ishin trajnuar për të matur kohën që u duhet 15 votuesve për të votuar në kabinën e votimit, në kohë të ndryshme gjatë ditës së zgjedhjeve.

Pak më shumë se gjysmës së votuesve (mesatarisht, në të gjitha zgjedhjet) u është dashur më pak se një minutë për të votuar, që nuk është befasi duke pasur parasysh faktin se ata


duhet të shënjonin vetëm një emër (prej 2-7 kandidatë). Gati një të tretës u është dashur koha prej 1-2 minuta për të votuar në kabinën e votimit, përderisa 8-16% u është dashur më shumë se 2 minuta për të votuar.

Duke pasur parasysh se fletëvotimi për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj ka qenë shumë i thjeshtë dhe ka kërkuar vetëm një shënjim, është e sigurt të thuhet se çdo votues që ka marr më shumë se një minutë kohë për të votuar (me përjashtim të votuesve të moshuar) ka mund të ketë qenë i zënë duke bërë diçka më shumë se thjeshtë duke votuar.

Votimi familjar dhe ai me asistencë

Votimi familjar vazhdon të jetë i pranishëm në të gjitha ciklet zgjedhore në Kosovë. Gjatë raundit të parë të zgjedhjeve, vëzhguesit kanë raportuar më shumë se një rast të votimit familjar në dy të tretat deri në tre të katërtat e vendvotimeve, përderisa më shumë se 10 raste të votimit familjar në 11% të vendvotimeve.


Votimi familjar



Shkalla e paraqitjes së këtij fenomeni tregon që votimi familjar nuk sfidohet nga komisionerët. KQZ duket që nuk i ka udhëzuar komisionerët për të parandaluar këtë. Ligji qartazi precizon që vetëm individët që janë analfabet mund të ndihmohen dhe një person mund të asistojë vetëm një votues por jo edhe të tjerë.

Shpeshësia e rasteve të votimit familjar tregon që në rastin më të mirë, një numër i madh i votuesve të moshuar (shumica e tyre femra) e kanë të shkelur fshehtësinë e votës dhe vullnetin e tyre. Në rastin më të keq, kjo mund të jetë teknikë për zbatuar blerjen e votës. Në vitin 2007, votimi familjar është vërejtur në 62% në raundin e parë dhe në 38% në raundin e dytë të zgjedhjeve (në nivel kombëtar)¹⁵.

Votuesit me ndihmë



Votimi me asistencë është i ngjashëm me votimin familjar. Në 18% të vendvotimeve në Ferizaj (raundi i parë) ka pasur më shumë se 10 votues që kanë kërkuar të ndihmohen gjatë votimit. Kjo shifër ka rënë në 13% në raundin e dytë. Në 40% të vendvotimeve në Kaçanik, kanë qenë më shumë se 10 votues që kanë kërkuar të votojnë me asistencë.

Vëzhguesit kanë raportuar që i njëjti person u ka ndihmuar më shumë se një votuesi në 13% të vendvotimeve në Ferizaj gjatë raundit të parë. Këto shifra ishin edhe më alarmuese në Kaçanik ku ky fenomen kishte infektuar 32% të vendvotimeve. Në të gjitha këto raste, kryesuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim kundër këtij fenomeni.

Është interesant që pjesa e votuesve që kanë votuar bashkërisht apo me asistencë është shumë më e lartë se sa

shkalla e raportuar e analfabetizmit. Numrat e mëdhenj që kanë votuar me asistencë e rrit shqetësimin që qindra individë që dinë të shkruajnë apo lexojnë janë të detyruar të votojnë me asistencë si mënyrë për të dëshmuar votën me porosi.

I njëjti person ka ndihmuar më shumë se një votues



Është më se e qartë se procedurat nuk janë ndjekur siç duhet, dhe të njëjtit individë u kanë asistuar shumë votuesve. KQZ duhet të inspektojë librin e votimit të mbajtur nga kryesuesit për të verifikuar nëse janë regjistruar të gjitha rastet e asistencës.

Votimi me kusht

Si edhe më parë, votimi me kusht ka qenë shumë i komplikuar për administratën e zgjedhjeve dhe ka shkaktuar dyshime. Siç është vërejtur, pa arsytim adekuat, shumë votues nuk janë lejuar të votojnë me kusht.

Pasaktësitë e mëdha në listën votuese deri diku mund të kenë ndikuar në numrin e votave me kusht. Është befasues dallimi në mes të raundit të parë dhe të dytë në Ferizaj. Në raundin e parë ishin 521 vota me kusht përderisa në raundin e dytë 607. Pas raundit të parë, afër 500 veta kanë ndërruar adresat e tyre (kanë azhuruar), dhe është dashur që dalja e votave me kusht do të duhej të ketë rënë para raundit të dytë. Këto të dhëna lënë hapësirë serioze për të dyshuar. Në Kaçanik kishte gjithsej 196 vota me kusht.

Parregullsi të konsiderueshme janë evidentuar edhe në

numërim gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve. Aty ishin 126 fletëvotime me kusht të pavlefshme prej gjithsej 607, apo gati një në pesë fletëvotime të hedhura me kusht. KQZ ka evidentuar tetë raste të personave që kanë votuar nga dy herë, një herë në mënyrë të rregullt dhe njëherë me kusht. Kryesuesja e KQZ ka sugjeruar që këta emra t'i dërgohen prokurorisë mirëpo nga KQZ nuk është marr asnjë vendim.

“Treni bullgar”

Vëzhguesit e shoqërisë civile janë udhëzuar që të jenë të kujdesshëm nëse pas numërimit vërehet ndonjë gjë tjetër në kuti (letër e bardhë apo fletëvotim jo i rregullt). Një letër e është gjetur në një vendvotim zakonisht është indikacion i fenomenit të quajtur “treni bullgar” - por që njihet me emra të ndryshëm.

Treni bullgar ndodh atëherë kur një fletëvotim merret me vete nga një votues dhe në vend të originalit në kuti fut një fletëvotim fals. Fletëvotimi i paplotësuar që është larguar nga vendvotimi, mund të mundësojë qindra të tjerëve që të shesin votën e tyre dhe të vendosin fletëvotimin origjinal sipas dëshirës së partisë që paguan. Votuesi i parë e dërgon fletëvotimin të partia politike, e cila e mbush sipas preferencave të saj dhe ua jep votuesve të tjerë. Votuesit tjerë të cilët janë në marrëveshje me subjektin, marrin një fletëvotim të zbrazët por dhe në kuti të votimit e hedhin fletëvotimin e nxjerrë nga xhepi të cilin e kanë marrë nga partia. Ky rreth mund të përsëritet deri në orët e mbrëmjes.

Një tregues që ky fenomen po ndodh janë grupet e njerëzve që sjellën përreth qendrës së votimit apo kur një fletëvotim i zbrazët gjendet brenda kutisë së votimit. Këtë herë, partitë ishin më të sofistikuara. Të vetëdijshëm se çdo material i paplotësuar mund të jetë tregues i mashtrimeve, ata kanë udhëzuar militantët e tyre që t'i hedhin fletëvotimet e tilla me kusht. Për më shumë, ata kanë hedhur fletëvotime të raundit të parë (e paqartë se si i kanë siguruar) në zarfet me kusht në raundin e dytë dhe i kanë marrë fletëvotimet origjinale me vete.

Tetë fletëvotime nga raundi i parë janë gjetur në kuti të votimit gjatë raundit të dytë. Fakti që ky nuk ka qenë një gabim teknik por një indikacion i përpjekjes sistematike për mashtrim është edhe dëshmia që ky fenomen është vërejtur në katër vendvotime të ndryshme (qendrat e votimit në fshatrat Mirashë dhe Surqinë, shkolla “Zenel Hajdini” dhe qendra mobile e votimit për persona me nevoja të veçanta). Një zarf është gjetur pa fletëvotim fare brenda, që gjithashtu është një indikator i qartë që fletëvotimi origjinal është marr me vete nga votuesi. Këta janë tregues të fuqishëm që kjo teknikë mashtruese është përdorur gjerësisht dhe ky është një argument shtesë që votimi me kusht duhet të hiqet.

Thirrjet dhe transportimi selektiv

Gjatë ditës së zgjedhjeve në Ferizaj dhe në Kaçanik, vëzhguesit tanë kanë vërejtur dy dukuri shqetësuese që kanë ngritur dyshime për manipulime të mundshme. Militantët partiak kanë organizuar skema masive të transportimit të votuesve nga shtëpitë e tyre nëpër vendvotime. LDK dhe PDK haptazi kanë pranuar që ata kanë organizuar transport pa pagesë për votuesit e tyre.

Megjithëse transportimi i votuesve nuk është i ndaluar me ligj, ekzistojnë dy shqetësime që lidhen me këtë skemë. Shqetësimi i parë është se transporti i tillë është organizuar në mënyrë të fshehtë dhe me vetura të vogla, që bën blerjen e votave shumë të lehtë. Një shqetësim tjetër që lidhet me këtë është se ky transport ka shpenzime të mëdha, prandaj “investitori” me gjasë konsideron që ndërmarrja e këtij veprimi do të shpërblehet mirë.

Mund të konkludohet që fitimi i zgjedhjeve është shumë shpërblyes, një indikacion ky i mundësisë për korrupsion. Sipas BIRN-it, në Ferizaj, Qazim Rrahmani (ish këshilltar i Qeverisë) dhe Danush Ademi (deputet) kanë organizuar dhe paguar nga 50 euro vozitësit e taksive për të transportuar votuesit nëpër vendvotime¹⁶. Është raportuar po ashtu, që

votuesit falas e kishin jo vetëm transportin por edhe “këshillat” se për cilin kandidat të votojnë. Për çudi, dalja në zgjedhje në radhët e komunitetit ashkali është më e larta e shënuar ndonjëherë, krahasuar me daljen e ulët në zgjedhje në radhët e komuniteti shumicë, shqiptarë.

Shqetësimi i dytë lidhet me formën e transportimit që është selektive. Grupet e njerëzve që shëtitnin nëpër korridore dhe përreth shkollave kanë qenë të përbërë nga vëzhgues partiakë. Megjithëse mund të krijohet përshtypja se ata kanë qenë të qetë, ata kishin detyra specifike. Vëzhguesit partiakë të vendosur nëpër korridore dhe oborre të shkollave rregullisht kanë shkëmbyer me kolegët e tyre brenda vendvotimeve. Vëzhguesit brenda vendvotimeve vazhdimisht u përcjellnin informata kolegëve të tyre jashtë dhe shumica e këtij informacioni ka qenë rreth asaj se kush ka votuar e kush jo (bazuar në nënshkrimet). Ky informacion ka bërë të mundur që të telefonohen votuesit - duke i fokusuar thirrjet dhe duke i transportuar votuesit që nuk kishin votuar ende.

Në vendvotimet në Kaçanik të Vjetër dhe në Doganaj, vëzhguesit e PDK-së vazhdimisht kanë kontrolluar listën e votuesve për të parë se kush nuk kishte votuar dhe pastaj i përcjellnin ato informata te militantët partiakë që po prisnin jashtë qendrave të votimit me vetura. Bazuar në këto informata, veturat shkonin në shtëpi private dhe ktheheshim me votues të rinj. Megjithëse konsiderohet e pranueshme që të bëhet transportimi i votuesve, është e papranueshme që vëzhguesit partiakë të kontrollojnë listën e votuesve për të parë se cilët individë kishin votuar e cilët jo. Veçanërisht, kjo ndodh me qëllim që të evitohet përdorimi i këtij informacioni për të shkuar nëpër shtëpitë e njerëzve dhe për t'i nxjerr ata për të votuar, duke ushtruar presion.


Thirrja e votuesve për tu treguar atyre se nuk kanë votuar, është një presion direkt. Fshehtësia e votës dhe legjislacioni mbi privatësinë duhet të rregullojnë këtë problem, dhe informata nëse një person ka votuar ose jo duhet të mbrohet me ligj. Prandaj, kjo praktikë e telefonatave të selektuara duhet të ndalohet. Kjo praktikë është veçanërisht shqetësuese kur

dihet se ekziston një regjim klientelist i cili lehtësisht mund të largojë individët nga puna në sektorin publik nëse ata nuk dalin në zgjedhje ditën e zgjedhjeve. Për më tepër, ndjenja se partia është e plotfuqishme dhe që di të gjitha mund të shpie tek frika e votuesve se partia e di se për kënd ata kanë votuar.

Forca e Sigurisë

Sipas ligjit, forcat e sigurisë nuk mund të hyjnë nëpër vendvotime përveç kur thirren nga udhëheqësi i VV dhe atë për të sjellë rend në procesin e votimit. Forcat e sigurisë janë ftuar për të sjellë rend dhe kontroll në 5,5% të vendvotimeve në Ferizaj ndërsa nuk janë ftuar kurrë në Kaçanik. Të paftuar, forcat e sigurisë kanë hyrë në 14,3% të vendvotimeve në Kaçanik dhe në më pak se 3% të rasteve në Ferizaj.

Forcat e sigurisë të paftuara në vendvotime




Tensionet kanë rënë gjatë raundit të dytë kur edhe është ulur numri i forcave të sigurisë në proporcion me vendvotimet. Obstruksioni është vërejtur në 4% të vendvotimeve gjatë procesit zgjedhor. Përgjithësisht, shumica e vendvotimeve nuk kanë pasur shqetësime të sigurisë. Në çdo të dhjetin rast, persona të paaautorizuar sillleshin rreth vendvotimeve me pretendimet për tu ofruar votuesve ndihmë në gjetjen e vendvotimit të tyre.

Trupi zgjedhor

Parregullsitë në listën e votuesve

Një problem i madh që D4D e ka ngritur në vazhdimësi është lista e votuesve që tani vëzhgimet nga terreni vetëm sa e konfirmojnë seriozitetin e këtij problemi. Problemet e pritura fatkeqësisht janë materializuar. Në mes të 6-17% të vendvotimeve në Ferizaj dhe Kaçanik kanë pasur probleme me mbi 10 votues që u është refuzuar votimi.

Vendvotimet me votues të refuzuar



Në gati një të tretën e vendvotimeve në Ferizaj (32,5% dhe 44,3% në raundin e dytë) një deri në dhjetë votues të cilët nuk kanë mundur të gjejnë emrin e tyre në listën e votuesve. Situata ka qenë më alarmuese në Kaçanik, ku kjo është manifestuar në 63,4% të vendvotimeve. Shumica e këtyre votuesve janë ankuar që herën e kaluar kishin votuar në të njëjtin vendvotim ku po kërkonin emrat e tyre, dhe tani ata nuk ishin në listën e votuesve. Kjo ka ndodhur “në shumicën e kohës” në 17% të rasteve në raundin e parë dhe 10% në raundin e dytë në vitin 2007¹⁷.

Ky problem ka rezultuar që shumë persona të votojnë me kusht, duke udhëtuar shumë kilometra larg për të votuar, apo duke hequr dorë fare nga votimi. Përgjithësisht, në mes

të 50-70% të vendvotimeve kanë pasur votues të refuzuar, një indikator ky i përjashtimit masiv që mund të ketë qenë një arsye shtesë për daljen e ulët në zgjedhje. Vëzhguesit kanë vërejtur që shumë votues nuk kanë mundur të gjejnë emrin e tyre në listën e votuesve, mesatarisht 4-20 persona për çdo vendvotim.

Votuesit janë ankuar që të afërm të tyre të vdekur gjenden ende në listën e votuesve. Në disa raste, të afërmit u kanë treguar vëzhguesve certifikatat e vdekjes së familjarëve të tyre e që ende figuronin në LV. Një punim tjetër i D4D ka publikuar të dhënat e një auditimi të listës së votuesve, përderisa këtu paraqesim vetëm gjetjet e dala nga vëzhgimi i zgjedhjeve në Kaçanik dhe Ferizaj.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është i vetëdijshëm që ka probleme serioze me listën e votuesve, duke përfshirë personat e vdekur, adresat e ndryshuara, diasporën, votuesit fiktiv dhe personat e futur në listë nga dy herë. Megjithëse KQZ është përgjegjëse për prodhimin e versionit final të listës së votuesve, autoritete të tjera qendrore dhe lokale janë të përfshirë në përgatitjen e saj, përkatësisht përgjegjësia më e madhe bie mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), që është përgjegjëse për mirëmbajtjen e Regjistrimit Civil.

Sa votues janë?

Sipas KQZ-së, në listën e votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme ishin 95.449 në Ferizaj dhe 31.473 në atë të Kaçanikut. Këta numra janë të fryrë nëse krahasohen me të dhënat e regjistrimit të popullsisë të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në prill të vitit 2011. Regjistrimi i popullsisë tregon që në Komunën e Ferizaj jetojnë 108.690 persona ndërsa 33.454 në Kaçanik. Për të qenë në gjendje që të krahasojmë këto të dhëna me listën e votuesve (për tu siguruar për nivelin e mospërputhjes) duhet të zbrisim numrin e të miturve e pastaj t'i krahasojmë

shifrat me të rriturit nga të dy burimet.

Mesatarja e të miturve nën moshën 18 vjeçare në Kosovë është rreth 35% të popullsisë. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe kalkulimeve tona¹⁸, në Ferizaj, proporcioni i të miturve (nën 18 vjeç) është 35,8% të popullatës së gjithmbarshme (35,5% në Kaçanik). Në momentin që zbresim numrin e të miturve (38.954) nga regjistrimi i popullsisë, nuk mbesin më shumë se 69.736 të rritur me të drejtë vote që jetojnë në komunën e Ferizajt (krahasuar me listën që ka 95.449).

Trendet zgjedhore në Ferizaj (2000-2012)

Madhësia e listës së votuesve		dallimi në % në vite	
Lokale (2000)	57,724		
Qendrore (2001)	63,867	10.60%	2000 - 2001
Lokale (2002)	76,350	19.50%	2001 - 2002
Qendrore (2004)	74,174	-1.40%	2002 - 2004
3 palë zgjedhje (2007)	89,741	7.00%	2004 - 2007
2 palë zgjedhje (2009)	88,306	-0.80%	2007 - 2009
Qendrore (2010)	91,876	4.00%	2009 - 2010
Të jashtëzakonshme për kryetar komune (2012)	95,449	2.60%	2010 - 2012
Regjistrimi (total banorë 2011)	108,690		
Llogaritja e mospërputhjes të votuesve me të drejtë vote ndërmjet regjistrimit të popullsisë dhe listës së votuesve			
Të miturit nën moshën 18 =	38,954	(35.84% e regjistrimit)	
Mbi 18 =	69,736	(të dhënat e regjistrimit - të miturit)	
Të dhënat e LV 2012 - të rritur sipas regjistrimit =	25,713	supozohet të vdekur dhe diasporë	

Dallimi në mes të listës së votuesve dhe të rriturve nga regjistrimi i popullsisë është 25.713. Kjo ndodh edhe për shkak se regjistrimi i popullsisë nuk përfshin edhe diasporën. Lista e votuesve përfshin diasporën, meqenëse shumica e tyre kanë të drejtë të votojnë. Në të njëjtën kohë,

nuk është sekret që lista e votuesve ka në vete me mijëra persona të vdekur, që regjistrimi i popullsisë nuk i përfshin.

Kjo shifër është alarmuese së pari sepse lë hapësirë të konsiderueshme për manipulime të mundshme. Me organizim të mirë, kjo është një hapësirë masive e cila mundëson votimin e falsifikuar me mundësi të vogla për tu kapur duke mashtruar.

Trendet zgjedhore në Kaçanik (2000-2012)

Size of the Voters List		% difference per year	
Lokale (2000)	24,905		
Qendrore (2001)	27,920	+12.1%	2000 - 2001
Lokale (2002)	30,337	+8.7%	2001 - 2002
Qendrore (2004)	31,948	+2.7%	2002 - 2004
3 palë zgjedhje (2007)	34,830	+3.0%	2004 - 2007
2 palë zgjedhje (2009)	29,397	-7.8%	2007 - 2009
Qendrore (2010)	30,308	+3.1%	2009 - 2010
Të jashtëzakonshme për kryetar komune (2012)	31,473	+2.6%	2010 - 2012
Regjistrimi (total banorë 2011)	33,454		
Llogaritja e mospërputhjes të votuesve me të drejtë vote ndërmjet regjistrimit të popullsisë dhe listës së votuesve			
Të miturit nën moshën 18 =	11,876	(35.5% e regjistrimit)	
Mbi 18 =	21,578	(të dhënat e regjistrimit - të miturit)	
Të dhënat e LV 2012 - të rritur sipas regjistrimit =	9,895	supozohet të vdekur dhe diasporë	

Situata në Kaçanik është e ngjashme me atë në Ferizaj. Me heqjen e numrit të të miturve, që është 35,5% bazuar në të dhënat e regjistrimit, figura që rezulton është 21,578 e të rriturve me të drejtë vote. Numri i votuesve po ashtu është zvogëluar me 7,8% nga viti 2007 krahasuar me vitin 2009, për shkak të krijimit të komunës së re të Hanit të Elezit.

Krahasimi i listës së votuesve me të dhënat e regjistrimit të

popullsisë jep 31,4% apo 9.895 persona që supozojmë që janë të vdekur apo në diasporë. D4D ka bërë një auditim të listës së votuesve në Kaçanik (që është botuar veçantë) dhe rezultatet e këtij auditimi fuqizojnë të gjeturat tona për mospërputhje në LV. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut tregon se 19% të personave që gjenden në listën votuese jetojnë në diasporë dhe 3% të personave në listën votuese janë të vdekur. Një numër tjetër prej 9% e 31,5% supozohet se jetojnë në Kosovë, por në ndonjë komunë tjetër ose këta janë personat për të cilët nuk kemi mund të gjejmë asnjë informacion.

Lista e votuesve 2012 Minus të dhënat e regjistrimit për të rritur = 9,895 (31.4%)

Shumica prej tyre të vdekur ose në diasporë. Siç ka treguar auditimi jonë i listës së votuesve në Kaçanik këto dy kategori kanë:	
Të vdekur:	3%
Diasporë:	19%
dhe 9% shtesë ndoshta shpjegohet me:	
Në komunat tjera të Kosovës:	5%
Nuk ka info për ta:	7%

Vëzhguesit kanë pranuar informacione të shumta që në shumë vendvotime, veçanërisht në fshatra, komisionarët kanë qenë të vetëdijshëm që shumë persona që gjenden në listën e votuesve, ose jetojnë jashtë Kosovës, në komuna të tjera të Kosovës apo janë të vdekur.

Kur KQZ pranoi ekstraktin më të ri të Regjistrimit Civil nga Ministria e Punëve të Brendshme, ata pranuan edhe një raport me emrat që gjenden në listën e votuesve që sipas të gjitha gjasave janë të vdekur. Megjithatë, për shkak të procedurave të komplikuar, këta emra nuk u hoqën nga lista e votuesve. Me 17 prill, KQZ vendosi të heqë nga lista 250 persona në Ferizaj pas marrjes së një raporti nga Sekretariati i KQZ-së. KQZ ishte gati e sigurt se edhe 1.300 emra të tjerë të personave të vdekur janë ende në listë.

Megjithatë, për shkak që certifikatat e vdekjes nuk përmbanin asnjë numër personal apo për shkak të gabimeve të tjera, ishte e pamundur që të hiqen.

Auditimi i LV në Gjurgjedell	
A. Vendndodhja si në LV	150
B. Tjetër vendndodhje	27
C. Tjetër komunë	23
D. Jashtë Kosove	104
E. Të vdekur	19
Nuk ka informata	13
Totali i votueseve të regjistruar në LV	336
Dalja e raportuar 2010	92.3%

Dalja në Gjurgjedell 2012	
31. Shukri Luta (VV)	35
32. Besim Ilazi (PDK)	36
33. Sahit Bela (LDK)	1
34. Kjani Berisha (AKR)	5
35. Tahir Çaka (AAK)	19
Totali	96
Dalja e raportuar 2012	28.9%
Dalja reale e llogaritur 2012	54.2%

Një shembull tjetër se sa problematike është LV dhe si mund të ketë efekte negative në tërë procesin zgjedhor tregon rasti i një fshati në Kaçanik. Rezultatet e auditimit në fshatin Gjurgjedell tregojnë se nga 336 votues të regjistruar në LV, 150 jetojnë në adresa të njëjta, 27 jetojnë brenda komunës së Kaçanikut, 23 votues jetojnë jashtë komunës së Kaçanikut por brenda Kosovës, 104 jetojnë jashtë Kosove, 19 janë të vdekur përderisa për 13 prej tyre nuk kemi mundur të marrim informata.

Rezultatet e vitit 2010 tregojnë se kanë votuar 92.3% apo rreth 310 veta nga fshati Gjurgjedell. Për të arritur daljen prej 92.3% është dashur të votojnë të gjitha kategoritë e lartë-cekura duke përfshirë edhe disa të vdekur.


Në vitin 2012 në Gjurgjedell në zgjedhjet për kryetar të komunës kanë votuar 96 veta apo 28.9% një indikacion që këtë herë nuk ka pasur votim në emër të të vdekurve dhe atyre në diasporë. Nëse do të bëhej pastrimi i LV atëherë dalja në Gjurgjedell do të ishte mbi 54%, një dalje reale dhe një legjitimitet me i lartë për kryetarin e zgjedhur.

Këto shifra tregojnë vetëm një pjesë të sfidës së vërtetë. KQZ

ka aprovuar listën e votuesve me 19 prill, me vetëm një votë kundër (Vetëvendosje), megjithëse ata ishin të vetëdijshëm për ekzistimin e problemeve. Më shumë do të duhej të bëhej nga KQZ dhe MPB për të zvogëluar hapësirën për parregullsi në listën e votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Dalja në zgjedhje

Dalja në zgjedhjet e jashtëzakonshme në vitin 2012 ishte e ulët, vetëm 31% në Ferizaj dhe 35% në Kaçanik. Dalja në balotazh në Ferizaj ishte edhe më e ulët se që pritej.



Dalja e ulët në zgjedhje mund të shpjegohet me kombinimin e dy faktorëve: (a) lodhja nga dalja e shpeshtë në votime, (b) mashtrimet në zgjedhje, (c) mandati i shkurtë i kandidatëve.

Siç është vlerësuar edhe në raporte tjera nga D4D, dalja e raportuar në zgjedhje nuk është reale sepse lista e votuesve është shumë e fryrë me qindra e mijëra persona të diasporës në listë por


edhe shumë të tjerë të vdekur e që ende nuk janë hequr nga lista.

Interpretimi i daljes

Dalja e vërtetë në zgjedhje është më e lartë se përqindja e treguar më lartë. Siç është argumentuar më parë në këtë punim, listat e votuesve përmbajnë mijëra emra të personave që janë shpërngulur jashtë apo që kanë vdekur. Është esenciale të krahasohen numrat e votuesve jo vetëm

me listën e pasaktë të votuesve por edhe me numrin e votuesve që jetojnë në një komunë.

Dalja reale në Kaçanik



Dalja prej 31% në zgjedhje duhet të vendoset në kontekst të listës jo të saktë të votuesve. Nëse i heqim nga lista numrin e të vdekurve dhe atyre që jetojnë jashtë, numri i votuesve mbetet 69.736, që është edhe numri i votuesve që mund të votojnë në Ditën e Zgjedhjeve.

Dalja e raportuar në zgjedhje e 28.643 prej gjithsej 69.736, përbën 41% që është dalja reale në zgjedhje nëse

listat e votuesve do të ishin të pastruara. Ngjashëm, në Kaçanik dalja prej 35% në zgjedhje do të ishte 51%. Ky është një mjet i dobishëm për të krahasuar daljen reale në zgjedhje me daljen në zgjedhje të raportuar nëpër hulumtime të ndryshme në mënyrë që të vlerësohen më mirë shifrat dhe të identifikohet dalja e dyshimtë kur është jashtëzakonisht e lartë.


D4D ka ndërmarrë një analizë të ngjashme për të gjitha komunat, dhe mospërputhja në nivel të Kosovës po ashtu del të jetë 31% (pas heqjes së votuesve që nuk jetojnë në atë komunë me daljen e raportuar në zgjedhje). Këto shifra tregojnë që një dalje prej 70% në zgjedhje me listën aktuale me shumë mangësi, teknikisht është i pamundshëm dhe me siguri një rezultat i tillë është rezultat i manipulimeve.

Dalja në Ditën e Zgjedhjeve

Vëzhguesit kanë shënuar shifrat e daljes në zgjedhje, tri herë

gjatë ditës së zgjedhjeve, që korrespondojnë me shifrat e prezantuara nga KQZ.

Dalja gjatë ditës së zgjedhjeve



Vetëm 11,5% e votuesve në Ferizaj kanë votuar deri në drekë, përdërisa në komunën më rurale të Kaçanikut, dalja deri në drekë ka qenë afër 14%. Në pjesë të tjera, dalja në zgjedhje gjatë kësaj ditë ka treguar disa trende interesante.

Ka pasur një dalje të madhe për të votuar në dy orët e fundit të Ditës së Zgjedhjeve. Rreth një e treta e votuesve kanë hedhur votën e tyre në mes të orës 17:00 dhe 19:00. Shumica e njohësve të zgjedhjeve janë të vetëdijshëm që pak votues dalin për të votuar në këtë kohë. Mbajtja e këtyre zgjedhjeve në pranverë ka qenë një rrethanë pozitive dhe moti ka qenë i mirë, mirëpo është një fakt i njohur që në zgjedhjet e mëparshme që janë mbajtur në vjeshtë, shumica e Kosovarëve zakonisht votojnë para orës 17:00.

Kjo votë e “minutës të fundit” ngrit shqetësime për mundësi të “kërcënimit” apo edhe “manipulimit” të votuesve për të votuar një kandidat të caktuar. Ky fenomen lehtësisht mund të jetë manipulues, veçanërisht në vjeshtë kur terri bie në pasditen e hershme.

Rezultatet e votimit

Zgjedhjet për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik kanë qenë zgjedhjet e para të mbajtura pas procesit zgjedhor me shumë mangësi të vitit 2010. Si në çdo proces tjetër zgjedhor, ato ishin edhe barometër i matjes së performancës së qeverisë qendrore dhe lokale por edhe një parashikim i votës së përgjithshme. PDK ka fituar të dy këto zgjedhje, duke u pasuar nga LDK në Ferizaj dhe AAK në Kaçanik.

Përkrahja për partitë politike në Ferizaj

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës në Ferizaj ishin një garë në mes tetë subjekteve politike. Të shtatë partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës që përfaqësojnë komunitetin shqiptar morën pjesë në garën për kryetar. Gara në Ferizaj është parë edhe si matje e pulsit publik duke qenë se Kuvendi i Kosovës tashmë kishte kaluar gjysmën e mandatit. Një kandidat i pavarur po ashtu ka marr pjesë por pati një performancë modeste. Nuk ka pasur asnjë koalicion parazgjedhor, as për partitë që janë në koalicion në nivelin nacional.

Prej 31% të atyre që kanë votuar, dy të tretat përkrahën PDK-në dhe LDK-në. Nëse supozojmë që militantët partiak kanë dalë për të votuar në të njëjtin nivel si në raundin e parë, atëherë më shumë se dy të tretat e votuesve të partive të tjera kanë votuar për njërin nga dy finalistët.

Në raundin e parë, Agim Aliu (PDK) morri vetëm pak më shumë se gjysmën e votave të fituara nga paraardhësi i tij në vitin 2009 dhe 9% më pak se që kishte fituar partia e tij në zgjedhjet për asamblenë komunale në 2009.

Pasi që LDD gati po shuhej, dega e saj iu ri-bashkua LDK-së e cila vuri për kandidat të saj udhëheqësin që ndau LDD-në nga LDK. Më herët, LDD ishte ndarë nga LDK-ja, që ishte shumë e fuqishme në Ferizaj (veçanërisht në vitin 2007 kur

ishite bindshëm partia e dytë politike më e madhe në Ferizaj).

Trendi i përkrahjes për partitë politike


Ferizaj	LDK	LDD	PDK	AAK	AKR	VV
Lokale 2000	28,141		11,077	821		
Qendrore 2001	26,846		11,727	1,763		
Lokale 2002	25,746		12,648	1,658		
Qendrore 2004	24,418		11,458	1,472		
Qendrore 2007	4,957	7,787	12,441	1,179	4,742	
Lokale 2007	4,989	7,704	12,050	1,379	4,897	
Kryetar Komune 2007	5,092	9,635	14,562	1,143	4,373	
Raundi i 2-të për kryetar komune 2007		8,697	14,902			
Lokale 2009	4,948	5,621	12,866	2,575	4,651	
Kryetar Komune 2009	4,411	6,100	19,360	1,722	6,233	
Qendrore 2010	8,892	1,556	12,199	2,307	3,372	7,429
Kryetar Komune 2012	6,903		11,712	3,116	1,403	4,564
Kryetar komune raundi i 2-të 2012	11,100		15,102			

Në vitin 2009, LDK kishte përkrahjen e 4.948 dhe LDD kishte përkrahjen e 5.621 votuesve. Në raundin e parë në vitin 2012, LDK (së bashku me LDD-në) fitoi 6.903 vota, vetëm 65% të votave të kombinuara që LDK dhe LDD kishin marrë veç e veç në vitin 2009. Salihaj po ashtu pati rezultat më të dobët krahasuar edhe me zgjedhjet nacionale të vitit 2010.

Humbësi më i madh i zgjedhjeve të vitit 2012 në Ferizaj ishte AKR, e cila humbi dy të tretat e votave të saj krahasuar me vitet 2009 dhe 2010. Arsyeja kryesore për këtë humbje serioze ishte edhe kalimi i kandidatit të saj të suksesshëm në AAK, i cili me ekip të ri fitoi 10% të votës së gjithmbarshme. AAK përmirësoi performancën e saj për një të tretën e votave si rezultat i kandidatit të saj të ri. AAK është partia e

vetme e cila ka përmirësuar performancën e saj krahasuar me zgjedhjet e kaluara.

Raundi i 1-rë në Ferizaj, rezultatet e kandidatëve



Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje! që po garonte për herë të parë, doli i treti me 4.564 vota por mori vetëm 61% të votave të fituara nga VV në Ferizaj gjatë zgjedhjeve nacionale.

Në balotazh, Aliu i PDK-së fitoi 29% më shumë vota se në raundin e parë (3.390 vota) përderisa kandidati i LDK-së fitoi 60% më shumë vota se në raundin e parë. Me gjithë votën e “zemërimit” që partitë e tjera i kishin dhënë kandidatit të dytë (si votë kundër PDK-së), kjo ishte e pamjaftueshme për ndikuar rezultatin final.

Analiza për zonat urbane/rurale

Dallimet ndërmjet zonave rurale dhe urbane janë ende të pranishme në Kosovë. Votat në zonat rurale janë më të disiplinuar, me dalje prej 32,4% krahasuar me 27,1% në zonat urbane¹⁹.

Kandidati i PDK-së fitoi përqindje pothuajse të barabartë si në qytet, ashtu edhe në fshatra, përderisa kandidatët e tjerë ishin të preferuar më shumë nga njëra zonë se tjera.

Kandidati i LDK-së, shënoi rezultate më të mira në zonat rurale ku morri afër 4% të votave më shumë se sa në qytet, dhe një trend i përafërt ishte edhe për AAK, AKR dhe PD. Vetëm kandidati i Vetëvendosjes pati favorizim më të madh në qytet, ku fitoi rreth 6% të votave më shumë në zonat rurale.

Rezultatet sipas zonave

Raundi I 1-re I Ferizaj Kandidatet	Urbane		Rurale	
	No	%	No	%
Naim Ferati (AAK)	1,407	10%	1,652	11%
Bujar Ademi (PD)	331	2%	407	3%
Faton Topalli (VV)	2,552	19%	1,963	13%
Rrahim Sadiku (IP)	65	0%	77	1%
Ramadan Hasani (AKR)	576	4%	788	5%
Agim Aliu (PDK)	5,470	41%	6,057	41%
Adem Salihaj (LDK)	2,985	22%	3,828	26%
Ramadan Emini (LB)	68	1%	43	0%
Vota të vlefshme	13,454	27%	14,815	32%
Ferizaj raundi I 2te	Urbane		Rurale	
	No	%	No	%
Agim Aliu (PDK)	6,503	60%	8,332	56%
Adem Salihaj (LDK)	4,394	40%	6,516	44%
Vota të vlefshme	10,897	100%	14,848	100%
Elektorati i përgjithshëm	49,728	22%	45,721	32%

Zhgënjimi i gjerë në Kaçanik

Duhet përmendur faktin që të gjitha partitë politike që morën pjesë në zgjedhjet e vitit 2012 për kryetarë komune kanë humbur përkrahje që nga zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2009.

Humbësi më i madh i zgjedhjeve në Kaçanik ishte LDK, e

cila doli me vetëm 615 vota. LDK arriti rezultatin e saj më të dobët që nga viti 2000, me 74% vota më pak se në vitin 2009. Përkrahja për AKR-në po ashtu ka rënë dhe kjo parti është radhitur e katërta me 541 vota (61% më pak vota se në vitin 2009).


AAK mori 43% vota më pak se në raundin e parë të zgjedhjeve të vitit 2009 për kryetar komune apo 60% më pak se në raundin e dytë të vitit 2009. PDK mori 5,845 vota apo 18% më pak se në zgjedhjen për kryetar komunë të vitit 2009. VV nuk kishte marrë pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2009 mirëpo krahasuar me vitin 2010, VV fitoi gati për një të tretën më pak krahasuar edhe me vitin 2010 (krahasimi i rezultatit të zgjedhjeve lokale të vitit 2012 me zgjedhjet nacionale në Kaçanik të vitit 2010). Nëse ky trend vazhdon në Kaçanik, atëherë legjitimiteti i atyre që qeverisin Kaçanikun do të jetë një problem i madh.

Dallimet në përkrahjen e partive politike

Kaçanik	LDK	LDD	PDK	AAK	AKR	VV
Lokale 2000	7,069		9,302	900		
Qendrore 2001	7,201		7,632	903		
Lokale 2002	7,910		8,643	844		
Qendrore 2004	7,205		9,329	918		
Kuvendi 2007	856	856	8,757	1,090	1,566	
Kuvendet lokale 2007	2,829	1,038	8,537	1,657	1,706	
Mayoral 2007	3,012	1,077	7,147	1,675	1,767	
Kryetar komune, raundi i 2-te 2007	3,291		9,662			
Kuvendet lokale 2009	2,205	333	6,374	3,411	1,068	
Kryetar komune 2009	2,299		7,008	3,860	1,303	
Kryetar komune, raundi i 2-te 2009			7,633	5,479		
Kuvendi 2010	2,137	206	6,491	1,965	938	2,607
Kryetar komune 2012	615		5,843	2,239	541	1,810

Fitorja e kandidatit të PDK-së, Besim Ilazi, ishte e pakontestueshme në Kaçanik, pasi që ai arriti të fitojë zgjedhjet qysh në raundin e parë me 53% të votave. Tahir Çaka nga AAK doli i dyti me pak më shumë se 20% të votave përderisa LDK befasisht morri vetëm 5% të votave.

Rezultatet e votimit në Kaçanik



Votat në zonat rurale dhe urbane në Kaçanik


Një analizë më e thellë e rezultatit të votimit për çdo vendvotim thekson dallime të mëdha në zonat urbane dhe rurale sa i përket votave. Besim Ilazi (PDK) morri gati 70% të votave në zonat rurale. Ilazi fitoi gati numrin e njëjtë të votave sa edhe kandidati i AAK-në në qytezë, me 31%, ndjekur nga kandidati i VV-së me 22%. Por, rezultati i PDK në zonat malore të Kaçanikut ishte i paarritshëm, me afër 90% në disa qendra të votimit.

Kërkohet hulumtim i mëtutjeshëm për të vlerësuar nëse PDK e ka përqendruar fushatën e saj më shumë në zonat rurale dhe sa ka ndikim kjo parti në fshatra.

D4D druan se thirrjet selektive telefonike dhe transporti mund të jenë një nga shpjegimet prapa dallimeve të mëdha


në rezultatet ndërmjet qytetit të Kaçanikut dhe fshatrave përreth. Partitë në Kosovë nuk kanë profile ideologjike, prandaj ka pak gjasa që të ekzistojnë dallime ideologjike madhore sipas lokaliteteve. Si krahasim, Ferizaj ka treguar që dallimi në trende të votimit ndërmjet fshatrave dhe qytetit është shumë i vogël. Për më tepër, dallimi në zhvillim, p.sh., ndërmjet Kaçanikut dhe fshatrave të tij nuk është shumë i madh krahasuar me dallimin e qytetit dhe fshatrave që kanë shumë qytetet në perëndim (p.sh. Munich-u kosmopolitan përballë Bavarisë konservatore).

Vota rurale, Kaçanik



D4D beson që kërcënimi indirekt i ushtruar përmes thirrjeve dhe mjeteve tjera është më efikas në fshatra. Për shkak të madhësisë së vogël të shumicës së fshatrave, prania e partisë është më efektive. Gjatë fushatës, ka pasur raporte që përkrahësit e partive opozitare nuk kanë ndjekur tubimet nga frika e hakmarrjes dhe largimit nga puna. Duhet një studim më i hollësishëm për të vlerësuar shkallën e kërcënimeve, dhe të gjenden mënyra për të evituar këto parregullsi.

Vota Urbane, Kaçanik



Votat e pavlefshme

Në një punim të mëhershëm, D4D ka treguar që mesatarisht niveli i votave të pavlefshme në vitin 2010 ka qenë 3,8%.

Votat e pavlefshme



Sidoqoftë, fletëvotimet për kryetarë komunash kanë qenë të thjeshta: ato kanë përmbajtur vetëm emrat e kandidatëve për kryetar komunash dhe është nevojitur vetëm një shenjë në një emër për të votuar. Në zgjedhjet e mëhershme kishte numër të konsiderueshëm të votave të pavlefshme për shkak të konfuzionit të shkaktuar nga dy-tri lloje të zgjedhjeve që janë mbajtur në të njëjtën kohë.

Në përgjithësi në Ferizaj ishin 327 vota të pavlefshme përderisa ishin 122 në Kaçanik. Është paksa më i dyshimtë trendi i votave të pavlefshme në raundin e dytë të zgjedhjeve në Ferizaj, ku niveli i tyre ka qenë më lartë për 1,6% apo në total kanë qenë 90 vota më shumë të pavlefshme. Fletëvotimi për raundin e dytë ka pasur vetëm dy emra, ku votuesit i është kërkuar që të shënjojë vetëm njërin prej tyre (në raundin e parë kanë qenë shtatë emra). Në raundin e dytë është më lehtë të votohet prandaj ka më pak gjasa që të kemi më shumë vota të pavlefshme.

Trendi në zgjedhjet e kaluara ka treguar që në përgjithësi ka më pak vota të pavlefshme në raundin e dytë të zgjedhjeve. Përveç kësaj, këto vota të pavlefshme, janë koncentruar më shumë në zona të caktuara, duke i bërë parregullsitë edhe më problematike. Ka pasur tri vendvotime ku niveli i votave të pavlefshme ka qenë 10% i votave të hedhura në atë vendvotim, gjë që duhet të hetohet nga KQZ-ja.

Gratë dhe grupet tjera më pak të përfaqësuara

Bilanci gjinor në KVV

Meshkujt kanë dominuar dukshëm përbërjen e anëtarëve të vendvotimeve, veçanërisht në zonat rurale. Gratë janë më mirë të përfaqësuara në Kuvend (për shkak të kuotës) sesa në vendvotime ku përfaqësimi i tyre varet vetëm nga fuqia për të depërtuar brenda subjektit.

Komisionerët femra

	Total	Urbane	Rurale
Ferizaj	21%	25%	17%
Kaçanik	9%	10%	8%

Çdo i katërti komisioner në qytetin e Ferizajt ka qenë femër, ndërsa në zonat rurale të Ferizajt femrat përbënin një të gjashtë të komisionarëve. Në Kaçanik përfaqësimi i gruas në vendvotime ka qenë edhe më i pabarabartë. Sipas formularëve të mbushur nga vëzhguesit tanë, vetëm 8,7% të femrave ishin komisionerë në ditën e zgjedhjeve në Kaçanik. Edhe vëzhguesit e partive politike ishin kryesisht meshkuj, mirëpo kjo nuk është matur në mënyrë sasiore. Në vitin 2007, rreth çdo i katërti komisioner ka qenë femër. Kështu, pjesëmarrja e gruas është përkeqësuar në Ferizaj dhe Kaçanik krahasuar me mesataren në Kosovë në vitin 2007²⁰.

D4D-ja e rithekson faktin që gratë kanë një rol të rëndësishëm në vendvotim, potencialisht e zvogëlojnë vjedhjen, dhe në përgjithësi e fuqizojnë pjesëmarrjen e gruas dhe daljen në votime.

Dalja e grave në zgjedhje

D4D-ja e ka matur daljen e grave në zgjedhje duke numëruar numrin e grave që kanë votuar brenda një gjysme ore të

caktuar me mostër të rastësishme në ditën e zgjedhjeve.

Nga totali i votuesve, 37,5% ishin femra (pa dallime në lokacion), bazuar në të dhëna të besueshme të mbledhura nga mbulimi i 111 vendvotimeve²¹. Në Kaçanik pjesëmarrja ishte paksa më lartë, 40% (42,4% në qytet dhe 38,7% në fshatra).

Përqindja e votuesve femra

	Femra	Meshkuj
Ferizaj	38%	62%
Kaçanik	40%	60%

Përderisa proporcioni i grave komisionerë në Kaçanik ka qenë më i ulët se në Ferizaj – 9% në Kaçanik kundrejt 21% në Ferizaj – dalja në votime e grave ka qenë më e lartë në Kaçanik. Dalja e lartë në Kaçanik mund të jetë një indikacion i mobilimit më masiv nga partitë politike. Në përgjithësi, kjo shifër paraqet një përmirësim krahasuar me vitin 2007, kur kjo ka qëndruar në shifrat e 33% në nivel Kosove²².

Kjo pjesëmarrje është më e vogël sesa e meshkujve por më shumë tregues është fakti se shumica e grave kanë ardhur të shoqëruara nga një mashkull (bashkëshorti apo djali). Vota e grave është asocuar shpesh me fenomenin e votimit familjar, gjë që tregon se shumë nga to nuk kanë votuar bazuar në vullnetin e tyre.

Personat me nevoja të veçanta

Mbi 2/3 e vendvotimeve nuk ofrojnë qasje për personat me nevoja të veçanta. Në zgjedhjet në Ferizaj, 68% e qendrave të votimit nuk kanë pasur qasje për votuesit e kësaj kategorie. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në 76% të qendrave të votimit në Kaçanik. Situata ka qenë befasisht më e keqe në zonat urbane (ku shumica e qendrave të votimit ishin shumëkatëshe) dhe 74% nuk kishin qasje. Në zonat rurale

situata ishte paksa më e mirë me 62% të qendrave që nuk kanë pasur qasje (sepse shumica e shkollave ishin ndërtesa përdhes). Për krahasim, situata tani duket më e keqe sesa në nivel Kosovë nga viti 2007 kur 54% e qendrave të votimit nuk kanë pasur qasje për personat me aftësi të kufizuar²³.

Numri i vogël i qendrave të votimit me qasje për personat me nevoja të veçanta e ul pjesëmarrjen e këtyre kategorive në zgjedhje. Një gjë e tillë vazhdon praktikisht t'u mohojë të drejtën për të votuar kësaj kategorie. Investimi në sigurimin e qasjes në qendra të votimit për personat me nevoja të veçanta do të ishte një investim me vend, gjë që do ofronte qasje për votuesit e kësaj kategorie po edhe për nxënësit me nevoja të veçanta, pasi që shumica e qendrave të votimit janë ndërtesa të shkollave publike. Duhet shtuar numri i shkollave që shërbejnë si qendra votimi dhe të ulet përdorimi i kateve të larta.

Përfundimet

Përvoja e hidhur e procesit të manipuluar zgjedhor të vitit 2010, me rinumërimet dhe rivotime, është relaksuar paksa me përmirësimet e procesit në Ferizaj dhe Kaçanik. Por do të ishte gabim që rënia e shkeljeve në këto zgjedhje të na shtyjë të jemi më të kënaqur sesa që duhet me administratën zgjedhore. Në fakt, dëshmia se edhe ky proces zgjedhor kishte hisen e vet të parregullsive, përfshirë presionin ndaj votuesve dhe raste të komisionarëve joprofesional dhe të politizuar, tregon se në shkallë më të madhe, procesi sërish do të ishte problematik.

Bazuar në rekomandimet nga D4D, KQZ ndërmori masa të domosdoshme për të ndarë postet e zyrtarit të identifikimit (kontrolluesve të letërnjoftimit) në mënyrë proporcionale tek të gjitha subjektet që garonin. Për më tepër, rekomandimet mundësuan që vëzhguesit të ripozicionohen prapa komisionarëve, që u lejon atyre të mbikëqyrin hallkën themelore të procesit të votimit. Problemet me listën e votuesve përsëriten dhe kanë shpie tek parregullsitë e votimit në emër të tjerëve, dhe votuesit duke u drejtuar tek lokacione të pasakta të votimit.

Komisionarët e vendvotimeve, që ishin në shënjestër të kritikave në procesin e manipuluar të vitit 2010, tani performuan më mirë. Mirëpo, sërish ka pasur raste kur nuk kanë arritur të parandalojnë apo të ndalin parregullsitë. Votimi familjar u vëzhgua në shumë vendvotime dhe vërehej trajnimi joadekuat i komisionerëve për disa nga procedurat.

Në cilësi të menaxherëve të qendrave të votimit, drejtorët e shkollave vazhduan të tejkalojnë kompetencat e tyre duke ndikuar në proces dhe duke mos u angazhuar sa duhet për të siguruar një klimë të qetë të votimit. Animet politike të drejtorëve, të cilët qartazi emërohen me kritere partiake, nxisin dyshime edhe për tavolinën ndihmëse të qendrave të votimit të cilët i emëron drejtori.

Dalja e ulët në zgjedhje në dy komunat – për postin e liderit të komunës që drejton resurset dhe zhvillimin – tregon një mungesë të besimit në procesin zgjedhor. Por gjithashtu, kjo mund të jetë edhe për shkak të faktit se listat e votuesve janë të fryra dhe përfshijnë edhe emra të personave që nuk banojnë në komunë dhe personave të vdekur.

Rekomandimet në vijim fokusohen në përmirësimin e menaxhimit të qendrave të votimit dhe të vendvotimeve. Ato propozojnë disa mekanizma që duhet të përfshihen në legjislacionin zgjedhor relevant për të eliminuar parregullsitë dhe për të shpie tek një administratë zgjedhore më pak e politizuar dhe më efektive.

Rekomandimet

Menaxhimi i qendrave të votimit

Drejtorët e shkollave duhet të kenë vetëm rol logjistik

Drejtorët e shkollave nuk duhet të jenë më menaxherë të qendrave të votimit. Ata duhet ta kenë vetëm një rol teknik në ditën e zgjedhjeve, që të aktivizojnë gjeneratorin nëse ndalon rryma dhe të hapin dhe mbyllin klasët për votime. Ky parim duhet të rregullohet me ligj dhe KQZ duhet të përgatitë një përshkrim të detajuar të punës për menaxherët e vendvotimeve.

Të depolitizohen tavolinat ndihmëse

Megjithëse KQZ-ja është shumë e vetëdijshme që shumica e drejtoreshave të shkollave janë të lidhur politikisht, ajo vendosi me shumicë votash që personeli i tavolinës ndihmëse në qendra të votimeve të emërohet nga menaxherët e qendrave të votimeve (drejtorët e shkollave), në vullnetin e tyre nga personeli i shkollës. Përbërja e tavolinës ndihmëse duhet gjithashtu të rregullohet me ligj, duke siguruar që ajo nuk është e lidhur dhe e ndikuar politikisht.

Komisionerët e vendvotimeve

Roli i komisionerëve

Roli i komisionerit gjatë ditës së zgjedhjeve është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Përgjegjësia e tyre duhet të rregullohet me ligj dhe jo të varet nga vullneti individual, ashtu siç ka qenë deri më tani. Rregullimi i roleve të komisionerëve përmirëson procesin zgjedhor dhe shmang politizimet e panevojshme.

Madhësia e KVV-së të rregullohet me ligj

KQZ-ja nuk duhet të ketë diskrecion për numrin e komisionerëve në një vendvotim të caktuar. Paraprakisht, KQZ shpesh ka marrë vendime për këtë çështje, nganjëherë duke zvogëluar numrin e komisionerëve për vendvotim në minimum. Numri duhet të rregullohet me ligj dhe asnjë vendvotim mos të cenohet nëse nuk ka pasur mjaft interes nga të gjitha subjektet.

Përfaqësimi gjinor në KVV

KQZ-ja duhet të miratojë një rregullore e cila siguron që 30% të komisionarëve të jenë femra. Deri më tani, përfaqësimi i gruas ka qenë shumë i ulët.

Komisionarët të mos jenë nga komunat prej nga vijnë

Anëtarët e KVV-së nuk duhet të jenë votues në komunat të cilët caktohen për të punuar në ditën e zgjedhjeve (dhe anëtarët e KVV-së duhet të jenë të komunave të ndryshme nga njëri tjetri).

Vëzhgimi

Kabinet e votimit duhet të kthehen në atë mënyrë që u mundëson vëzhguesve të shohin shpinën e votuesit

Në këtë pozicion të ri, fshehtësia e votës ruhet dhe zvogëlohet mundësia e ndërrimit të fletëvotimit me ndonjë fletë tjetër të ngjashme. Gjithashtu zvogëlohet mundësia për të fotografuar fletëvotimi apo për të ndërruar fletëvotimin e zbrazët me fletëvotim që nxjerrët nga xhepi.

Vëzhguesit duhet të lejohen që të ulen prapa komisionerëve në vendvotime

Duke u ulur prapa komisionarëve, vëzhguesit do të kenë mundësinë që të ndjekin më për së afërmi procesin e votimit.

Të reduktohet numri i vëzhguesve të partive politike

Partitë politike të cilët marrin pjesë në procesin zgjedhor duhet ta kenë të drejtën e emërimit të vetëm një vëzhguesi në vendvotim, dhe kjo duhet të rregullohet me ligj. Përderisa shumica e partive politike janë të përfaqësuara me një komisionar në KVV, një vëzhgues është i mjaftueshëm. Gjithashtu numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar duhet rregulluar me ligj ku subjektet politike do të kenë të drejtë të akreditojnë vetëm 10% më shumë vëzhgues sesa që është numri i vendvotimeve. Numri i madh i vëzhguesve të akredituar të partive politike krijon turma të panevojshme brenda dhe jashtë vendvotimeve dhe këta përdoren për të ushtruar presion.

Bexhat të jenë tërë kohën të dukshëm

Në shumë vendvotime sillen persona të cilët mbajnë bexha të kthyer mbrapsht. Kjo praktikë duhet rregulluar me rregullore të veçantë të KQZ-së ku do të parashiheshin dënime të ashpra për personin që mban bexhin mbrapsht si dhe për subjektin të cilit i takon. Në rastet kur personi bart bexhin e ndonjë personi tjetër për të hyrë në vendvotim duhet trajtuar si manipulues të zgjedhjeve dhe duhet ndjekur penalisht konform dispozitave ligjore.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ)

Duhet të zvogëlohen kompetencat ligjvënëse të KQZ-së

Korniza e tashme i jep KQZ-së kompetenca të mëdha ligjvënëse. Rregullat zgjedhore më të rëndësishme duhet të përfshihen në ligj. KQZ-ja duhet të jetë zbatues i ligjeve zgjedhore dhe jo ta ketë rolin e ligjvënësit.

Të shtohen kompetencat e Sekretariatit

Sekretariati i KQZ-së duhet të marrë më shumë kompetenca për tu transformuar në një organ më profesional që është funksional dhe nuk varet nga Komisioni me përbërje politike. Gjithashtu duhet investuar më shumë në trajnimin dhe profesionalizimin e sekretariatit.

KQZ e balancuar në mes të pozitës dhe opozitës

Të balancohet përbërja e anëtarëve të KQZ-së. Përjashtuar Kryesuesin, duhet të ketë numër të barabartë të përfaqësuesve nga pozita dhe opozita. Së pari, vendet u caktohen partive të cilët përfaqësojnë grupe që garojnë për vende të rezervuara në Kuvend dhe vende të tjera caktohen për të arritur një baraspeshim në mes të pozitës dhe opozitës dhe të parandalohet mbivotimi. Formula e njëjtë duhet të përdoret për përbërjen e Këshillave Komunal Zgjedhor dhe KVV-ve.

Një doracak i detajuar procedural

Doracakë për komisionerët duhet të përshkruajnë detajet më të vogla. Përveç doracakëve të trajnimit, duhet hartuar doracakë shtesë për procedurat. Në shumë raste gjatë ditës së zgjedhjeve, komisionarët kanë qenë në pozita kur nuk kanë qenë të sigurt se çfarë të bëjnë. Përderisa një doracak paraprak i përdorur nga OSBE nga viti 2001 deri 2007 ka qenë shumë i detajuar, doracaku i ri që është përdorur në

zgjedhjet e fundit ka lënë pa rregulluar shumë çështje me rëndësi. Pas çdo zgjedhje, doracakët e trajnimeve duhet të përditësohen me raste të reja dhe zgjidhje të ofruara për këto zgjedhje.

Trajnimi i KVV-ve duhet të përmirësohet

Komisionerët shpesh nuk janë të sigurt si duhet të reagojnë në situata të caktuara. Përveç doracakut, duhet përmirësuar ndjeshëm nivelin e trajnimit për komisionarët. Komisionarët duhet të trajnohen për aspekte të ndryshme të ndjeshme, p.sh. për rastet kur votuesit insistojnë të votojnë edhe pse pranë emrit të tyre ekziston një nënshkrim.

Futja e disa procedura të reja

Numri i procedurave të reja përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: (a) testimi i detyrueshëm i pajisjeve përpara vëzhguesve gjatë mëngjesit të hershëm në përgatitjet e ditës së zgjedhjeve, (b) vendosja e obligueshme e informacionit si votohet, (c) materialet e ndjeshme të paketohen nga prodhuesi dhe kjo ambalazhi të verifikohet para hapjes së vendvotimit në prani të vëzhguesve.

Siguria

Sigurimi duhet të obligohet të parandalojë militantët që shprehin propagandë politike nga hyrja në qendrat e votimit.

Votimi familjar

KQZ duhet të organizojë fushatë kundër votimit familjar dhe të udhëzojë komisionerët se si të merren me këto raste, të udhëzojnë votueset për të drejtën e tyre dhe të insistojnë me këmbëngulje për të reduktuar rastet e votimit familjar.

Qasja për personat me aftësi të kufizuara

KQZ-ja duhet të kërkojë mbështetje për hapësira për qasje të

personave me aftësi të kufizuara dhe të insistojë që të hapen më tepër vendvotime në katet përdhes.

Fushatë dinamike për edukim të votuesve

Ka nevojë për një edukim të votuesve nga KQZ me përqendrim në përgjegjësitë e votuesve dhe informata si votohet. Kjo mund të ulë votat e pavlefshme dhe të rrisë daljen.

Të mirëmbahet rregullisht web-faqja e KQZ-së

Problemet në qasje dhe në freskimin e informatave në web-faqen e KQZ-së ngritin dyshimin nëse ajo është e aftë të organizojë zgjedhje në Kosovë. KQZ mund të rrisë besimin në aftësinë e sajë organizative nëse siguron qasje të duhur në web faqen e saj.

Të qartësohet se me cilat dokumente mund të votohet

Nuk janë të pakta rastet e raportuara ku tentohet të votohet edhe me kartela të bankës, kopje të letërnjoftimeve, pasaporta të huaja etj. KQZ duhet të qartësojë për publikun dhe për komisionerët se cilat dokumente janë të lejuara për të votuar. Lista e këtyre dokumenteve duhet të jetë publike dhe të vendoset nëpër secilin vendvotim. Nuk duhet lejuar që komisionerët apo komisionet komunale zgjedhore në bazë të dëshirës së tyre të vendosin se cilat dokumente i pranojnë e cilat jo.

Lista e votuesve

Një fushatë më e fuqishme për përmirësim të listës së votuesve

Përmirësimi i listës së votuesve duhet të jetë prioritet i KQZ-së si dhe i MPB-së. Nëse nuk është reale të pritët riparimi i tërë regjistrimit civil, KQZ duhet të iniciojë proces tjetër duke

lëshuar kartela votimi vetëm për personat e pranishëm në Kosovë.

Diaspora duhet të vendoset në një listë të veçantë

Duke marrë parasysh që një numër i madh i diasporës (300,000 deri në 400.000 emra) shfaqen në listën e votuesve, ndërsa vetëm një numër i vogël (rreth 5.000) prej tyre votojnë me postë, atëherë mundësitë për mashtrim dhe votim në emër të tjerëve ekzistojnë. Diaspora duhet të lejohet të votojë përmes një liste të veçantë të votuesve e cila i vihet në dispozicion përfaqësive diplomatike.

Largimi i emrave të personave të vdekur nga lista

Ministria e Punëve të Brendshme duhet të identifikojë mekanizmat për zbatimin e sanksioneve që rrjedhin nga Ligji për Gjendjen Civile për mos-deklarimin e vdekjeve. Duhet të hiqet taksa komunale për certifikatën e vdekjes të si një nxitje për të raportuar vdekjet në një shkallë më të lartë.

Subjektet politike

Subjektet politike nuk duhet të inkurajojnë fëmijët që të paraqiten në fushatë. Ata nuk duhet të ushtrojnë presion tek shërbyesit civil (shëndetësor dhe të arsimit) për të ndjekur tubimet. Thirrja e qytetarëve me telefon nuk është e ndaluar por kjo duhet rregulluar me ligj për të parandaluar shantazhin. Roli përgjegjës i subjekteve politike në kontrollimin e militantëve partiakë nuk duhet anashkaluar dhe si rrjedhojë nuk duhet hequr dënimet kolektive për subjektet politike.

Ligji për partitë politike

Kuvendi i Kosovës duhet të hartojë ligjin për partitë politike si dhe për financat e tyre. Ligji për partitë politike do të ndihmonte demokratizimin e tyre si dhe rritjen e

transparencës karshi votuesve dhe ligjit. Votuesit do të mund të përcillnin zhvillimin e demokracisë brendapartiake përdërisa organet kompetente do të përcillnin edhe mënyrën e financimit të partive politike.

Rezultatet dhe drejtësia në zgjedhje

Raportimi i rezultateve

Të bëhet e detyrueshme që të raportohen të gjitha rezultatet në format të njëjta nga viti në vit dhe të zbërthyerat për vendvotim. Edhe rezultatet e anuluarat duhet të publikohen për transparencë.

Përgjegjësitë e KQZ-së sipas zinxhirit të përgjegjësive

Përgjegjësia duhet të kërkohet përgjatë zinxhirit të përgjegjësive deri tek KQZ-ja në lidhje me shkeljet procedurale në ditën e zgjedhjeve.

Fusnotat

¹ The Economist. 13 dhjetor 2012. Kosovo's election: Calm now, a storm to come? [Zgjedhjet në Kosovë: Qetë tani, pritjet një stuh] Versioni online.

http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovo_election (qasur për herë të fundit me 15 gusht 2012).

² KTV. 19 prill 2012. Emisioni Interaktiv mund të shikohet: <http://www.kohavision.net/video/interaktiv/3936/> (qasur për herë të fundit me 26 nëntor 2012).

³ D4D. 27 prill 2012. Raport paraprak për mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme në komunën e Ferizajt. <http://www.d4d-ks.org/ferizaji/raport-paraprak-per-mbarevajtjen-e-fushates-zgjedhore-per-zgjedhjet-e-parakohshme-ne-komunen-e-ferizajt/> (qasur për herë të fundit me 19 shtator 2012).

D4D. 25 maj 2012. Komunikatë për media – Vëzhgimi i raundit të dytë të zgjedhjeve në komunën e Ferizajt. (<http://www.d4d-ks.org/ferizaji/komunikate-per-media-vezhgimi-i-raundit-te-dyte-te-zgjedhjeve-ne-komunen-e-ferizajt/>) (qasur për herë të fundit me 19 shtator 2012).

D4D. 15 qershor 2012. Mbarëvajtja e fushatës zgjedhore dhe plani për ditën e zgjedhjeve. <http://www.d4d-ks.org/ferizaji/mbarevajtja-e-fushates-zgjedhore-dhe-plani-per-diten-e-zgjedhjeve-17-qershor-2012/> (qasur për herë të fundit me 19 shtator 2012).

⁴ D4D. 17 qershor 2012. Komunikata 1 (08:00) Dorëzimi i materialeve të ndjeshme, shpërndarja e vëzhguesve dhe hapja e vendvotimeve. <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-pare-per-zgjedhjet-ne-ferizaj/>. Raundi i dytë Ferizaj: <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-pare-e-zgjedhjeve-te-raundit-te-dyte-ne-ferizaj/>. Kaçanik: <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-pare-per-zgjedhjet-ne-kacanik/> (qasur për herë të fundit me 12 nëntor 2012).

⁵ D4D. 29 prill 2012. Komunikata 2 (13:30). Dalja në votime deri në ora 12:00 dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor. <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-dyte-per-zgjedhjet-ne-ferizaj/>. Raundi i dytë Ferizaj <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e->

dyte-e-zgjedhjeve-te-raundit-te-dyte-ne-ferizaj/. Kaçanik: <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-dyte-per-zgjedhjet-ne-kacanik/> (qasur për herë të fundit me 12 nëntor 2012).

⁶ D4D. 29 prill 2012. Komunikata 3 (18:00) Dalja në votime deri në ora 17:00 dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor. Komunikatat mund të gjenden këtu: Raundi i parë Ferizaj <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-trete-per-zgjedhjet-ne-ferizaj/>.

Raundi i dytë Ferizaj: <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-trete-e-zgjedhjeve-te-raunit-te-dyte-ne-ferizaj/>. Kaçanik: <http://d4d-ks.org/aktivitetet/komunikata-e-trete-per-zgjedhjet-ne-kacanik/> (qasur për herë të fundit me 12 nëntor 2012).

⁷ Takim i KQZ-së. 19 Prill 2012

⁸ Kjo ka ndodhur në shkollën e Bujqësisë Zenel Hajdini

⁹ Qendra e Votimit në Doganaj: 2502; Vendvotimi: 01D.

¹⁰ Procedura standarde është që votat të vendosen në thasë në fund të procesit të votimit, pasi që ato të jenë numëruara nga komisionerët në vendvotim. Pastaj ato duhet të kthehen prapë në kutitë e votimit për transport në Qendrën e Numërimit dhe të rezultateve.

¹¹ Malazogu, Leon. Shkurt 2008. Analizë e Trendeve Zgjedhore: Trendet dhe Mësimet e nxjerra. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Prishtinë, f. 12.

¹² Po aty, f. 12.

¹³ Kjo është raportuar në qendrën e votimit 2501D/04R, shkolla fillore “Tefik Çanga”.

¹⁴ Kjo është raportuar tek vendvotimi 2503x/05D SH. F. “Jeronim De Rada”.

¹⁵ Ibid. p. 11.

¹⁶ Besa Shahini. 3 May 2012. Selam prej Ferizajt. Gazeta Jeta në Kosovë. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1015,2057> (qasur për herë të fundit me 20 shtator 2012).

¹⁷ Malazogu, Leon. February 2008. Election Analysis: Trends and Lessons Learned. Kosovar Institute for Policy Research and Development. Prishtinë, p. 12.

¹⁸ Rezultate jozyrtare preliminare të regjistrimit të popullsisë në 2011 nga Agjencia Statistikore e Kosovës tregojnë se 28.03% të popullatës së Kosovës janë në grupin e moshës 0-14 ndërsa 27.47% janë në

grupin 15-29. Duke ndarë shumën prej 27.47% në katër pjesë të barabarta, shohim se 6.87% janë në grupin e moshës 15-18. Shumëzimi i grupit të moshës 0-14 dhe atij 15-18 japin rezultatin e 34.90% të popullatës nën moshën 18 vjeç. Një formulë e tillë është përdorur për Ferizaj-në dhe komunat e tjera.

¹⁹ Fletëvotimet me kusht nuk janë përfshirë në këtë llogaritje.

²⁰ Malazogu, Leon. Shkurt 2008. Analizë e Trendeve Zgjedhore: Trendet dhe Mësimet e nxjerra. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Prishtinë, f. 40.

²¹ Rezultatet nga 13 vendvotime nuk janë konsideruar, duke u cilësuar si të pabesueshme.

²² Malazogu, Leon. Shkurt 2008. Analizë e Trendeve Zgjedhore: Trendet dhe Mësimet e nxjerra. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Prishtinë, f. 12.

²³ Po aty, p. 10.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324(496.51-2)

Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme : analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik / Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi - Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2013. - 74 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

1. Malazogu, Leon 2. Kllokoqi, Selatin

ISBN 978-9951-608-06-0

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

ISBN 978-9951-608-06-0



9 789951 608060